

BAHRI BECI

GJUHA SHQIPE, SA E BUKUR, SA E MIRË!

GJUHA SHQIPE 9
për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
Podgoricë, 2009

Dr. Bahri Beci

GJUHA SHQIPE, SA E BUKUR, SA E MIRË

GJUHA SHQIPE 9

për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT

ALBANSKI JEZIK, KAKO LIJEP, KAKO DOBAR

ALBANSKI JEZIK 9

za deveti razred devetogodišnje osnovne škole

PRIRUČNIK

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Redaktor: Zarija Brajoviq

Recenzentë: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Artan Haxhi
Qamil Maraj, mësues i lëndës mësimore
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof. dr. Vehbi Hoti

*Korrektor letrar
dhe gjuhësor:* Rrok Gjolaj

Disenjoja dhe faqosja: Sasha Protiq

Redaktor teknik: Rajko Radulloviq

Për botuesin: Nebojsa Dragoviq

Shtypur në Studio "Mouse"; Podgoricë

Tirazhi: 50

ISBN: 978-86-303-1412-4

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3-154 të datës 31.08.2009 e ka miratuar këtë komplet mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRA E LËNDËS

KAPITULLI I PARË

1. Përshkruajmë ambiente	6
2. Fjalitë e paplota	8
3. Stilet funksionale	10
4. Stili letrar-artistik	11
Përmbledhje e njohurive	

KAPITULLI I DYTË

5. Biseda telefonike	13
6. Intervista	14
7. Stili shkencor	16
Përmbledhje e njohurive	
Punë e pavarur	17

KAPITULLI I TRETË

8. Reklama	18
9. Ndërtimet me parafjalë	20
Përmbledhje e njohurive	

KAPITULLI I KATËRT

10. Lajmi	22
11. Reportazhi	23
12. Stili publicistik	25
Përmbledhja e njohurive	

KAPITULLI I PESTË

13. Lutja ose kërkesa zyrtare	26
14. Stili administrativ	28
15. Emrat foljorë	30
Përmbledhja e njohurive	

KAPITULLI I GJASHTË

16. Plotësojmë formularë	32
17. Gjuha letrare ose standarde	33
18. Variante gjuhësore joletrare ose jostandarde	34
19. Ligjërimi bisedor	35
Përmbledhja e njohurive	
Punë e pavarur	37

KAPITULLI I SHTATË

20. Njoftimet publike	39
21. Shkrimi i fjalëve me vizë në mes	40
Përmbledhja e njohurive	

KAPITULLI I TETË

22. Tregimi	42
23. Fjalitë pavetore	44
24. Fjalorët dhe përdorimi i tyre	46
25. Korrektimi letrar i tekstit	47
Përmbledhja e njohurive	

KAPITULLI I NËNTË

26. Familjet e gjuhëve	48
27. Historia e gjuhës shqipe	50
28. Historia e standardizimit të shqipes	51
29. Dialektet e shqipes	52
Përmbledhja e njohurive	

Në vend të parathënies

Kompleti i teksteve të gjuhës amtare për klasën e nëntë përbëhet nga *Libri i nxënësit, Fletorja e punës* dhe *Libri i mësuesit*. Ato janë vazhdim i kompletit të teksteve të gjuhës amtare për klasën e tetë. Edhe struktura e tyre është e njëjtë me to, në fillim të çdo kapitulli jepet se çfarë do të mësohet dhe çfarë do të përsëritet, pastaj në katër ose pesë mësimë jepen njohuritë e reja dhe në fund të kapitullit jepet përmbledhja e njohurive të kapitullit.

Libri i nxënësit ka nëntë kapituj. Çdo kapitull ka një ose dy mësimë që u kushtohen gjuhës së folur dhe të shkruar : *Përshkruajmë ambiente, Biseda telefonike, Intervista, Reklama, Lajmi, Reportazhi, Lutja ose kërkesa zyrtare Plotësojmë formularë, Njoftimet publike, Tregimi*. Këto mësimë synojnë t'i ushtrojnë e aftësojnë nxënësit të lexojnë, të analizojnë dhe të kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme joletrare, si edhe të njohin veçoritë e ndërtimit e të funksionimit të tyre si mjet komunikimi me gojë ose me shkrim. Disa nga temat e këtyre mësimëve si *Bisedat telefonike, Reklama, Përshkrimi, Tregimi, Lajmi, Njoftimi, Plotësojmë formularë* janë trajtuar edhe në klasat nga e gjashta deri tek e teta. Në klasën e nëntë, sipas rastit, ato trajtohen më gjerësisht dhe në mënyrë më të thelluar duke shtuar edhe njohuri të reja. P.sh. deri në klasën e tetë nxënësit kanë mësuar se ç'janë reklamat, llojet dhe veçoritë e tyre, kurse në klasën e nëntë shkohet më tutje në disa veçori specifike të tilla siç janë përdorimi i humorit në reklamë ose ndalimi i përdorimit në reklama i fyerjes ose urrejtje nacionale, fetare, racore, etj. ose vënia në dukje e faktit që, shpesh herë, autorët e reklamave i vlerësojnë më shumë se janë në të vërtetë prodhimet e tyre me qëllim që të ndikojnë mbi lexuesit, dëgjuesit dhe shikuesit që të blejnë prodhimet e tyre edhe kur ato nuk kanë nevojë për to etj. Për këtë arsye, u rekomandojmë mësuesve që të lexojnë patjetër ligjin për reklamat në Tekstin mësimor dhe ta komentojnë atë me nxënësit. Në klasën e nëntë, për herë të parë, parashtrihen kërkesa për të njohur veçoritë e intervistës dhe reportazhi si edhe dhe për të bërë vetë intervista dhe reportazhe.

Në klasën e nëntë u kushtohen pesë mësimë të veçanta problemeve të stilistikës: *Stilet funksionale, Stili letrar-artistik, Stili shkencor, Stili publicistik, Ligjërimi bisedor*.

Pjesa tjetër e Librit të nxënësit i kushtohet veçorive të sistemit gjuhësor të shqipes, si edhe disa problemeve që lidhen me gjuhën në përgjithësi dhe kulturën e gjuhës në veçanti: Familjet e gjuhëve, Historia gjuhës shqipe, Historia e standardizimit të shqipes, Gjuha letrare ose standarde, Variantet gjuhësore joletrare ose jostandarde, Dialektet e shqipes, Korrektimi letrar i tekstit, Fjalorët dhe përdorimi i tyre, sigurisht në përputhje me kërkesat e programit dhe me veçoritë e moshës.

Parimi bazë i punës në klasën e nëntë do të jetë ai i klasës së tetë. Nxënësve nuk do t'u jepen të gatshme rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore, po do t'i zbulojnë ato vetë gjatë procesit mësimor dhe do të aftësohen t'i zbatojnë në praktikën e gjuhës së folur dhe të shkruar.

Mësimet për gramatikën dhe drejtshkrimin fillojnë me një tekst ose me disa fjali të ndjekura nga një sistem pyetjesh, të cilat bëjnë të mundur që nxënësit, sigurisht, nën drejtimin e mësuesit ose mësueses, të arrijnë vetë në përfundimet gramatikore që përbëjnë njohuritë e reja që do të përvetësohen. Kjo mënyrë e parashtrimit të njohurive të reja jo vetëm i nxit dhe i ushtron nxënësit të arsyetojnë, po edhe bën që ata t'i zbulojnë vetë njohuritë e reja. Pra, përmes pyetjeve kalohet nga e njohura tek e panjohura, duke nxitur kështu të mësuarit logjik dhe aftësimin e nxënësve për të nxjerrë përfundime. Në ndonjë rast janë përdorur si bazë nisjeje për shpjegimin e nocioneve gjuhësore tabela ose skema. Po edhe ato ndiqen nga një sistem pyetjesh që bëjnë të mundur të arrihet në përfundime që shënojnë njohuritë e reja që do të mësohen. Në përgjigje të pyetjeve të planifikuara nxënësit thonë lirisht mendimet e tyre, arsyetojnë përgjigjet, dallojnë çfarë është e drejtë dhe e gabuar në përgjigjet e tyre, përcaktojnë ku është gabimi dhe bëjnë vetë korigjimin e gabimeve të tyre. Në këtë mënyrë ata arrijnë vetë në përfundime të drejta; kështu bëhet e mundur që njohuritë e fituara të jenë të plota e të qëndrueshme. Jo gjithmonë nxënësit nxjerrin përfundimet e dëshiruara. Në këto raste është e nevojshme ndihma dhe ndërhyrja e mësuesit ose mësueses. Mësuesi në këto raste mund të bëjë edhe pyetje plotësuese. Nxënësit nuk duhet të mësojnë përmendsh të dhënat dhe përkufizimet. E rëndësishme është njohja e fenomeneve gjuhësore, dallimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore dhe, veçanërisht, zbatimi praktik i tyre në gjuhë e folur dhe të shkruar.

Në fund të çdo kapitulli ndodhet një përmbledhje e shkurtër e lëndës së mësuar.

Libri ka në tërësinë e tij synim themelor zhvillimin e aftësive për të dëgjuar, lexuar, folur dhe shkruar. Është me rëndësi që gjatë gjithë veprimtarisë mësimore të nxiten nxënësit të flasin, të shkruajnë dhe t'i shprehin lirisht mendimet, t'i mbrojnë qëndrimet e veta dhe t'i argumentojnë përgjigjet. Mësuesi nuk duhet të shqetësohet edhe në qoftë se nxënësit bëjnë gabime në përkufizimet e koncepteve dhe nxje-

rrjen e përfundimeve. Mësuesi duhet t'i ndihmojë të kuptojnë vetë se ku kanë gabuar dhe t'i korrigjojnë vetë gabimet e tyre.

Në Librin e nxënësit janë parashikuar edhe dy projekte a punë të pavarura, në të cilët nxënësit duhet të zbatojnë gjithçka që kanë mësuar në kuadër të mësimeve për zhvillimin e gjuhës së folur dhe të shkruar dhe të krijojnë vetë diçka të re.

Fletorja e punës konkretizon, verifikon, përforcon dhe çon më tutje punën e bërë përmes Librit të nxënësit. Ajo është e ndarë në të njëjtat njësi si edhe Libri i nxënësit, sepse është paraparë që të punohet me të krahas Librit të nxënësit. Kërkesat janë renditur nga më të lehtat tek më të vështirat. Nuk është e thënë që të gjithë nxënësit duhet t'i zgjidhin saktë të gjitha kërkesat (kjo varet nga interesimi dhe nga aftësitë e tyre).

Mund të ndodhë që disa nxënës t'i zgjidhin shpejt ushtrimet në Fletoren e punës, sepse janë të thjeshta dhe të lehta. Mësuesi duhet të ketë të përgatitura ushtrimet shtesë më të vështira, por interesante të cilat duhet t'i përdorë në përputhje me mundësitë e çdo nxënësi.

Kompleti nuk ka detyra shtëpie. Nuk janë harruar, por kemi synuar që përparësi t'i japim punës në shkollë. Sigurisht mësuesi ose mësuesja mund të japë detyra shtëpie. Për këtë mund të përdoren disa nga ushtrimet në Fletoren e punës, të cilat nuk mund të realizohen në orën e parashikuar. Po kjo nuk duhet të bëhet metodë pune sidomos në qoftë se mësuesi ose mësuesja mendon se nuk ka mundësi t'i korrigjojë ato.

Për të verifikuar dhe përforcuar njohuritë dhe shprehitë e fituara, mësuesi mund të hartojë vetë dy ose tre teste gjatë vitit.

Libri i mësuesit jep procedurën që sugjerohet të ndiqet për çdo mësim dhe me të gjitha shpjegimet e nevojshme për çdo orë mësimi. Ata janë dhënë si propozime për organizimin e orës së mësimi, po mësuesi është plotësisht i lirë të zgjedhë vetë metodën e punës në përshtatje me kushteve konkrete të klasës dhe të përvojës së punës së tij. E rëndësishme është të arrihen qëllimet dhe të plotësohen standardet e parashikuara.

Në Librin e mësuesit janë planifikuar edhe orët për zbatimin e programit, po edhe këto nuk janë të detyrueshme. Mësuesi ose mësuesja mund t'i ndryshojë ato në pajtim me veçoritë konkrete të nxënësve të klasës së tij.

Për mësimin e gjuhës në klasën IX janë caktuar 67 orë mësimi, kurse për mësimin e letërsisë 45 orë mësimi. Komuniteti lokal duhet të marrë pjesë në hartimin e 20% të Programit mësimor (10% për mësimin e gjuhës dhe 10% për mësimin e letërsisë). Për 29 mësime ne kemi parashikuar 53 orë mësimore.

PROPOZIM PËR NDARJEN ORËVE

Kapitujt	Numri i orëve
Kapitulli i parë	8
Kapitulli i dytë	5
Kapitulli i tretë	5
Kapitulli i katërt	5
Kapitulli i pestë	6
Kapitulli i gjashtë	5
Kapitulli i shtatë	4
Kapitulli i tetë	6
Kapitulli i nëntë	4
Punë e pavarur	5
Gjithsej	53

Gjatë punës së drejtpërdrejtë me nxënësit, mësuesi ose mësuesja do të shohë se cilave koncepte dhe tema duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje dhe në varësi të kësaj do ta planifikojë punën për orët e tjera të mësimi.

Po ashtu, mësuesi duhet të ketë parasysh edhe numrin e orëve të mësimi për zhvillimin e hartimeve, dy hartime në semestrin e parë dhe dy hartime në semestrin e dytë.

Mësimi 1

Përshkruajmë ambiente

Synimi: të zhvillojnë nxënësit aftësinë e të shikuarit, të dëgjuarit, të lexuari dhe të kuptuarit të një teksti të shkurtër joartistik që përshkruan ambientin e brendshëm dhe të jashtëm; të aftësohen të shkruajnë në mënyrë të pavarur tekste të tilla; të gjejnë e të dallojnë të dhënat e rëndësishme në tekst dhe në bazë të tyre të aftësohen që të hartojnë planin e punës për hartimin e një teksti; të zhvillojnë aftësinë e të folurit të pavarur për një temë paraprakisht të përgatitur (përshkrimi i ambientit të brendshëm dhe të jashtëm);

Janë të nevojshëm: dy biseda të regjistruara në magnetofon, një zyrtare dhe një jozyrtare.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në tërësi tekstin *Kulla e Mazrrekajve*;
- bën pyetje lidhur me përshkrimin e pamjes së jashtme të kullës: *Çfarë ke mësuar për kullën e Mazrrekajve duke e lexuar këtë tekst? Për çfarë flitet në pjesën e parë? Sa kate ka kulla? Prej çfarë materiali janë ndërtuar muret? Çfarë janë frëngjitë dhe ku ndodhen? Çfarë ka në muret rrethues? Çfarë ka në oborrin e kullës?;*
- nxirret përfundimi se **në pjesën e parë është përshkruar pamja e jashtme e kullës**, se përshkrimi i pamjes së jashtme të një ndërtese apo mjedisi, quhet përshkrim i jashtëm, se në përshkrimin e jashtëm përshkruhen pjesët e veçanta të pamjes së ndërtesës ose të mjedisit të jashtëm në përgjithësi, se kur përshkruajmë pjesën e jashtme, mund të fillojmë nga pamja e jashtme e ndërtesës, nga pamja e përgjithshme e mjedisit dhe pastaj të përshkruajmë veçmas hollësitë e veçanta;
- vijon me pyetjet për pjesën e brendshme të kullës: *Çfarë përshkruhet në pjesën e dytë të tekstit? Si hyhet në kullë? Përse shërben kati i parë? Çfarë ka në katin e dytë? Po në katin e tretë? Çfarë është divani? Si është dhoma e miqve?;*
- nxirret përfundimi se **në pjesën e dytë është përshkruar pamja e brendshme e kullës**, se përshkrimi i pjesës së brendshme të një ndërtese apo mjedisi, quhet përshkrim i brendshëm, se, ashtu si tek përshkrimi i pjesës së jashtme, edhe këtu përshkruhen karakteristikat e rëndësishme të cilat lidhen me njëra-tjetrën dhe se krejt përshkrimi është objektiv;
- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin *Në sheshin mbretëror*;
- bën pyetjet: *Çfarë përshkruhet në këtë tekst? Çfarë objektesh përshkruhen konkretisht dhe me çfarë radhe? Çfarë fjalësh mbizotërojnë në këtë përshkrim? Çfarë arrihet me këtë gjë? Gjej në tekst fjalët, shprehjet dhe fjalitë me të cilat autorja shfaq ndjenjat e veta;*
- kërkon nga nxënësit të shohin tabelën në vijim dhe në bazë kësaj të thonë si është realizuar subjektiviteti dhe besueshmëria e këtij përshkrimi;
- kërkon të krahasojnë këtë përshkrim me përshkrimin e kullës së Mazrrekajve, të thonë se ku qëndron ndryshimi ndërmjet tyre dhe cili është funksioni i njërit dhe i tjetrit tekst?;
- nxirret përfundimi se në përshkrimin objektiv të një ambienti të brendshëm ose të jashtëm, autori paraqet ose numëron vetëm karakteristikat kryesore të ambientit, kurse në përshkrimin subjektiv autori paraqet edhe përshkrimet vetjake, atmosferën, ndjenjat dhe mendimet e veta, se fillimisht përshkruhet pamja e përgjithshme dhe pastaj jepen veçoritë karakteristike të atij ambienti;
- gjenden elementet e përshkrimit të ambientit të jashtëm dhe vërehen se me ç'mjete gjuhësore është realizuar karakteri subjektiv i tekstit;
- u jep detyrë nxënësve që të shkruajnë me shokun ose shoqen e bankës një përshkrim të shkurtër të brendisë së një ambienti, duke u mbështetur në veçoritë e dhëna në *Librin e nxënësit*. U thotë se përshkrimin mund ta plotësojnë me paraqitjen e ndjenjave të veta.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- ora e mësimit mund të fillojë me leximin e detyrave që u janë dhënë nxënësve në orën e mëparshme të mësimit;
- bën pyetjet: *Çfarë përshkruhet në këtë tekst? Ç'të dhëna jepen për pamjen e jashtme të kësaj ndërtese? Ç'gjëra të veçanta ka kjo ndërtesë? A është përshkrimi subjektiv apo objektiv? U kërkon nxënësve që t'i argumentojnë përgjigjet e veta;*
- kërkon nga nxënësit të bëjnë ushtrimet nr. 1-6 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 2

Fjalitë e paplota

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e fjalive të paplota dhe t'i gjejnë ato në tekste të llojeve të ndryshme.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë çfarë janë fjalitë njëkryegjymtyrëshe, sa llojesh janë ato dhe ku dallohen fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore nga fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore;
- kërkon të lexojnë tekstin *Shtëpia fluturuese*;
- bën pyetjet: *Çfarë përshkruhet në këtë tekst? Çfarë objektësh përshkruhen konkretisht dhe me çfarë radhe? Cila është veçantia e kësaj shtëpie? Përshkrimin që keni lexuar është: a) përshkrim i pjesës së brendshme të shtëpisë, b) përshkrim i pjesës së jashtme të shtëpisë? Përshkrimi është: a) subjektiv, b) objektiv?* Kërkon nga nxënësit t'i argumentojnë përgjigjet;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* fjalitë në vijim;
- kërkon të rilexojnë fjalitë e shkruara me shkronja të zeza, të thonë çfarë fjalish janë ato;
- pyet nëse fjalisë: *Asnjë përgjigje*. i mungon: a) kryefjala ose b) kallëzuesi; se me cilën prej fjalëve (*mjeku, i sëmuri, asnjë*) mund të shprehin pjesën e fjalisë që mungon;
- pyet nëse fjalisë: *-Ndoshta në spital* i mungon: a) kryefjala ose b) kallëzuesi; se me cilën prej fjalëve (*do të kenë shkuar, do të kenë dalë, do të jenë nisur*) mund të shprehin pjesën e fjalisë që mungon dhe të gjejnë pjesët kryesore të secilës prej fjalive të tjera si edhe të thonë për çdo fjali pjesën që mungon;
- nxirret përfundimi se fjali të paplota janë ato fjali të cilave u mungojnë gjymtyrët kryesore ose të dyta, po që nënkuptohen nga konteksti ose situata; se fjalitë e paplota janë shumë të shpeshta në përgjigje, kur nga pyetja kuptohet ajo që është lënë pa thënë në përgjigje, se karakteristikat e fjalive të paplota janë: paplotësia, ekonomizimi i formulimit, ekspressiviteti (përshkrimi i situatave të papritura, shqetësuese, të tendosura) dhe saktësia e pamjaftueshme, se këto fjali të shkëputura nga konteksti, janë të pakuptueshme;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë e të krahasojnë në *Librin e nxënësit* fjalitë në vijim;
- bën pyetjet: *Çfarë dallimesh vini re ndërmjet fjalive të grupit a dhe b? Thoni çfarë fjalish janë?* Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet e veta;
- kërkon të bëjnë detyrat nr. 1- 6 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 3

Stilet funksionale

Synimi: të mësojnë nxënësit të dallojnë shtresëzimin funksional të gjuhës në varësi të situatës, të pikësnyimit të tekstit etj.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* katër tekstet me radhë;
- kërkon të shpjegojnë se në cilat situata përdoret secili prej këtyre katër teksteve, se cili tekst ka si qëllim që të informojë publikun për diçka që ka ndodhur; se në cilin tekst përdoren shprehje profesionale për të shpjeguar një dukuri të caktuar, se në cilin tekst mënyra e të drejtuarit është zyrtare dhe u kërkon ta argumentojnë këtë me të dhëna nga teksti;
- kërkon të gjejnë tekstin që karakterizohet nga përdorimi i fjalëve të figurshme ose me ngjyrim emocional si edhe mjetet gjuhësore të veçanta të përdorura në secilin prej tyre (*fjalë, ndërtime të fjalive, përdorime të trajtave të ndryshme të fjalëve* etj.);
- nxjerrin përfundimet që tekstet e mësipërme, megjithëse janë shkruar të gjithë në gjuhën letrare ose standarde, dallohen nga njëri-tjetri, sepse secili prej tyre përdor mjete gjuhësore të veçanta (*fjalë, ndërtime fjalish, trajta të ndryshme fjalësh* etj.), se ato u përkasin katër stileve të veçanta: *letrar-artistik, publicistik, shkencor dhe administrativ*.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin në vijim;
- bënë pyetjet: *Cilit stil i përket pjesa e mësipërme? Cili është efekti i përsëritjes dhe i shkurtimeve të fjalive?*;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr. 1-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 4

Stili letrar-artistik

Synimi: të mësojnë nxënësit karakteristikat e stilit letrar-artistik dhe t'i dallojnë tekstet letrare-artistike nga tekstet në stilet e tjera.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin *Magjia* të Ismail Kadarese;
- bën pyetjet: *Kush është autori i këtij teksti? Çfarë bën autori në këtë tekst? Teksti është: a) subjektiv, b) objektiv?* dhe kërkon t'i argumentojnë përgjigjet me të dhëna nga teksti. Kërkon të gjejnë mbiemrat më të cilët shkrimtari pasqyron bukur gjendjen shpirtërore të fëmijëve;
- kërkon të lexojnë tekstin *Krenaria e një toreadori* të Ernest Eminguejt;
- bën pyetjet: *Kush është autori i këtij teksti? Çfarë bën autori në këtë tekst? Teksti është: a) subjektiv, b) objektiv?* dhe kërkon t'i argumentojnë përgjigjet me të dhëna nga teksti. Kërkon ta krahasojnë këtë përshkrim me përshkrimin në tekstin e mëparshëm dhe të thonë ku qëndron ndryshimi;
- bën pyetjen: *Dy fragmentet janë shkruar: a) në gjuhën jostandarde, b) në gjuhën standarde?* dhe kërkon ta argumentojnë përgjigjen e tyre. Vijon me pyetjen: *Tekstet që lexuat janë fragmente të një: a) artikulli gazete, b) veprë letrare, c) autobiografie, ç) njoftimi, d) punimi shkencor* dhe kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- nxirret përfundimi se të dy këto tekste janë shkruar në stilin letrar-artistik, se në stilin letrar-artistik janë të gjitha veprat letrare në prozë, poezi dhe dramë, se veprat e shkruara në këtë stil synojnë të ngjallin te lexuesi ndjenjën e së bukurës, se gjuha e këtyre teksteve karakterizohet nga përdorimi i fjalëve me ngjyrim të theksuar emocional, nga përdorimi i figurave të shumta letrare, sidomos në poezi.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit t'i përgjigjen pyetjes se cilat nga dukuritë në vijim janë karakteristike për stilin letrar-artistik;
- i ndan nxënësit në grupe. U jep detyrë të zgjedhin secili sipas dëshirës, një tekst në prozë, në poezi, në dramë dhe të përcaktojnë karakteristikat e stilit letrar-artistik që kanë vënë re në këtë tekst;
- mund t'u japë grupeve edhe detyra të veçanta. Për shembull:
 - Gjeni figurat letrare në tekstin që keni zgjedhur.
 - Thoni shprehjet me të cilat theksohet qëndrimi subjektiv i shkrimtarit ndaj asaj që shkruan.
 - Thoni mjetet shprehëse stilistike të përdorura në tekst.
 - Përpiquni të tregoni mesazhin e tekstit që keni zgjedhur.
 - Thoni për ç'gjë dallohet ky tekst letrar-artistik nga teksti i shkruar në një stil tjetër, për shembull publicistik;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 5

Biseda telefonike

Synimi: të përforcojnë nxënësit njohuritë për bisedën telefonike dhe të aftësohen të bëjnë biseda telefonike zyrtare ose jozyrtare.

Janë të nevojshëm: dy biseda telefonike të regjistruara në magnetofon, një jozyrtare dhe një zyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- bën pyetjet: *Cilat janë llojet e bisedës telefonike? Ku dallohen bisedat telefonike zyrtare nga bisedat jozyrtare?*;
- Kërkon nga nxënësit të dëgjojnë dy bisedat e regjistruara dhe të thonë se çfarë bisedash janë: zyrtare apo jozyrtare dhe kërkon ta argumentojnë përgjigjen me të dhëna nga tekstet;
- lexojnë bisedën telefonike në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjet: *Kush flet dhe me kë flet? Cili është arsyeja e bisedës? Çfarë marrëdhëniesh kanë bashkëbiseduesit? Cilës lloj të bisedës telefonike i përket biseda e mësipërme?*;
- nxirret përfundimi se biseda telefonike mund të jetë zyrtare ose jozyrtare, se biseda e mësipërme është zyrtare, se biseda zyrtare dallohet nga biseda jozyrtare nga mënyra e prezentimit të bashkëbiseduesve, nga kultura e të folurit dhe nga fjalët që përdorim;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr. 1-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 6

Intervista

Synimi: të mësojnë nxënësit se çfarë është intervista dhe cilat janë karakteristikat e saj.

Është e nevojshme: një intervistë e shkurtër e regjistruar në magnetofon.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të dëgjojnë intervistën;
- bën pyetjet: *Cilës formë të stilit publicistik ipërket teksti që dëgjuat? Cila është veçoria kryesore e intervistës në krahasim me format e tjera të stilit publicistik? Cila është tema e intervistës? Cilët janë bashkëbiseduesit?*
- nxirret përfundimi se intervista është formë e të shprehurit gazetaresk, që dallohet prej formave të tjera të stilit publicistik nga forma dhe nga përmbajtja, se për intervistën ka rëndësi motivi, zgjedhja e temës, zgjedhja e bashkëbiseduesit, mënyra si bëhen pyetjet etj.;
- kërkon të lexojnë intervistën në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjet: *Çfarë është ky tekst? Kush pyet? Kush u përgjigjet pyetjeve? Për ç'arsye bëhet biseda? Nga cila pjesë e tekstit e kupton këtë gjë? Pse janë shtypur pyetjet me shkronja të ndryshme nga përgjigjet? Cili nga pjesëmarrësit e bisedës ka folur më shumë? Pse? A është teksti publik apo personal?*
- nxirret përfundimi se intervista është biseda që bën një gazetar me një person tjetër për ta pyetur për jetën e tij, për projektet e tij, për idetë e tij etj., me qëllim që t'ia bëjë të njohura publikut të gjerë, se ajo është një nga format e stilit gazetaresk ose publicistik, se për të bërë një intervistë nevojitet një arsye, se duhet treguar kujdes në zgjedhjen e temës dhe të personit, me qëllim që intervista të jetë cilësore, se, gjithashtu, ka shumë rëndësi formulimi i pyetjeve dhe se intervista mund të publikohet në radio, në televizion dhe në organet e shtypit;
- kërkon të bëjnë ushtrimin nr.1 në *Fletoren e nxënësit*.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fton nxënësit të lexojnë tekstin *Si bëhet intervista* në *Librin e nxënësit*;
- organizon diskutimin për përmbajtjen e tekstit;
- kërkon të shkruajnë një skicë të shkurtër për intervistën, duke u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve: *Ç'është intervista? Cilat janë karakteristikat e një interviste të mirë? Përveç pyetjeve dhe përgjigjeve, çfarë tjetër mund të përmbajë intervista?*
- skica e pritur do të ishte pak a shumë si kjo:
Intervista është forma e stilit publicistik në të cilën gazetari bisedon me një personalitet të rëndësishëm për një temë të rëndësishme. Karakteristikat e intervistës së mirë janë: tema aktuale dhe e rëndësishme, njohja e shkëlqyer nga ana e gazetarit e temës, zgjedhja e goditur personit që do të pyetet, gjatësia dhe formulimi i pyetjeve. Përveç pyetjeve dhe përgjigjeve, intervista mund të përmbajë një hyrje me të dhënat më kryesore, fotografi etj.;
- kërkon të vazhdojnë intervistën me drejtoreshën e shkollës në *Librin e nxënësit*;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet nr. 2-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 7

Stili shkencor

Synimi: të mësojnë nxënësit ç'është stili shkencor, kur përdoret ky stil, cilat janë karakteristikat e tij dhe nga se dallohet ai prej stilit letrar-artistik.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tre tekstet në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjen: *Cili tekst është shkruar me stilin letrar-artistik?* Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- vijon me pyetjet: *Cilat janë karakteristikat e stilit letrar-artistik? Cili tekst karakterizohet nga qartësia dhe nga saktësia? Në cilin tekst janë përdorur fjalë të huaja? Në cilin tekst fjalët janë përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë? Pse? Në çfarë stili janë shkruar dy tekstet e para? Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet;*
- Nxirret përfundimi se dy tekstet e para janë në stilin shkencor, se karakteristikat e stilit shkencor janë: *saktësia, qartësia, përdorimi fjalëve të huaja e të specialitetit, dhënia e fakteve, theksimi grafikisht i titujve, kapitujve, numrave etj.;*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fton nxënësit të lexojnë testin *Stili shkencor* në *Librin e nxënësit*;
- organizon diskutimin për përmbajtjen e tekstit;
- duke iju referuar të dhënave të tekstit të lexuar, kërkon të shkruajnë një skicë të shkurtër për intervistën;
- kërkon të lexojnë tekstin *Plutoni*;
- kërkon të gjejnë fjalinë që është shkruar në stilin shkencor dhe të thonë se cilat karakteristika të stilit shkencor dallojnë në atë fjali;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet nr. 1-3 në *Fletoren e nxënësit*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Punë e pavarur

Profesioni im i preferuar

Synimi: të fitojnë nxënësit shprehitë e kërkimit dhe të punës së pavarur dhe të aftësohen të pyesin dhe të përgjigjen mbi një tematikë të caktuar.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- ndan nxënësit në pesë grupe;
- çdo grup mendon pyetjet e veta për bashkëbiseduesin me temën *Profesioni im i preferuar*. Bashkëbiseduesit janë *mjekja* (grupi 1), *balerina* (grupi 2), *mësuesja* (grupi 3), *aktori i teatrit* (grupi 4), *kuzhinieri* (grupi 5);
- për të menduar pyetjet nxënësit kanë në dispozicion 20 minuta. Pyetjet duhet të shkruhen në stendë ose në një fletë letre të madhe. Përfaqësuesi i çdo grupi ka në dispozicion tre minuta për të lexuar pyetjet. Stendën ose fletën e madhe të letrës e var në dërrasë të zezë ose në murin e klasës. Dhjetë minutat në vazhdim nxënësit i krahasojnë pyetjet dhe, me ndihmën e mësuesit, zgjedhin pesë prej tyre që do t'ua bëjnë bashkëbiseduesve;
- në fund të orës së mësimit, nxënësit i shkruajnë pyetjet që do t'u drejtojnë bashkëbiseduesve;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- nxënësit sjellin intervistat dhe, në grupe, tregojnë kujdes për formën e intervistës, që pyetjet të jenë të shkurtra dhe të qarta;
- nëse biseda është regjistruar në magnetofon, duhet ta rishkruajnë atë, duke treguar kujdes për mënyrën e ndarjes së pyetjeve nga përgjigjet me shkronja të tipit bold dhe italic. Nëse është në dorëshkrim, pyetjet duhet të shkruhen me shkronja shtypi, kurse përgjigjet me shkronja dore. Për rregullimin e intervistës kanë në dispozicion 15 minuta;
- përfaqësuesi i çdo grupi ka në dispozicion 5 minuta për të prezentuar para klasës intervistën e grupit të vet. Intervista e shkruar duhet të vihet në stendë, në dërrasë të zezë, në murin e klasës afër dërrasës së zezë;
- në fund të orës së mësimit (pesë minuta), nxënësit, me ndihmën e mësuesit, nxjerrin përfundimet për mendimin e bashkëbiseduesit lidhur me profesionin e preferuar.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 8

Reklama

Synimi: të zhvillojnë nxënësit aftësinë për të dëgjuar, lexuar e kuptuar reklamën dhe për të mbajtur qëndrim kritik ndaj tyre.

Janë të nevojshëm: dy lajme të regjistruara nga radioja ose nga televizioni të regjistruara në magnetofon; një lajm objektiv dhe një subjektiv.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-6 në Fletoren e punës. Përmes tyre do të përsëriten njohuritë për reklamën (çfarë është reklama, llojet e reklamave, qëllimi i reklamave etj);
- kërkon të lexojnë tekstin *Bukuria dhe mrekullia (Mali i Zi)* dhe reklamën që vjen pas në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në tekstin e parë dhe të dytë? Çfarë ka dashur të arrijë autori i tekstit të parë dhe çfarë autori i tekstit të dytë? Cili tekst është më objektiv? Pse? Cili nga këto dy tekste është reklamë? Kërkon nga nxënësit të shpjegojnë përgjigjet.*
- nxirret përfundimi se reklama është një shpallje e porositur dhe e paguar që synon t'i bindë lexuesit, shikuesit dhe dëgjuesit për të blerë një mall, për të pranuar një shërbim, për të vizituar një vend etj.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë reklamën në vijim dhe u bën pyetjet: *Kush është porositësi i reklamës së parë? Në cilin tekst flitet për një prodhim të ri? Kërkon që në reklamën e dytë të gjejnë elementin me të cilin tërhiqet vëmendja e lexuesit;*
- kërkon të vështrojnë reklamën në vijim;
- bën pyetjet: *Kush është porositësi i reklamës? Çfarë reklamohet? Kujt i drejtohet reklama? Për se shërben teksti në këndin e sipërm majtas? Për se shërben teksti në drejtkëndëshin ngjyrë rozë? Cili është slogan i kësaj reklame?;*
- nxirret përfundimi se autori i reklamës, për të tërhequr vëmendjen e njerëzve që u drejtohet, shkruan pranë fotografisë ose sloganit të reklamës diçka me humor, se për të tërhequr vëmendjen e njerëzve nganjëherë prodhimin e reklamojnë personalitete të njohura të muzikës, të sportit etj., se reklamën nuk duhet të përmbajnë dhunë, fyerje ose urrejtje nacionale, fetare, racore etj., se ndaj reklamave duhet të jemi të kujdesshëm, sepse, shpesh herë, autorët e tyre nuk janë objektivë dhe i vlerësojnë më shumë se ç'janë në të vërtetë prodhimet e tyre, me qëllim që të ndikojnë mbi lexuesit, dëgjuesit dhe shikuesit për t'i blerë ato edhe kur nuk kanë nevojë;
- u tërheq vëmendjen nxënësve për një qëndrim kritik ndaj reklamave dhe u rikujton se jo gjithçka që reklamohet është më e mirë dhe më cilësore;
- në fund, kërkon të lexojnë e të komentojnë *Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve*, pjesën që ka të bëjë me reklamën.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 9

Ndërtimet me parafjalë

Synimi: të dallojnë dhe të përdorin nxënësit drejt në gjuhën e folur dhe të shkruar ndërtimet me parafjalë.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- paraprakisht i porositi nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* të klasës së gjashtë mësimet për rasat;
- bën pyetjen: *Sa rasa ka emri?*;
- jep për analizë katër fjali të thjeshta, ku rasa emërore pa parafjalë është: në funksion të kryefjalës, të pjesës emërore të kallëzuesit emëror, të ndajshtimit dhe të thirrorit;
- rithekson se emri në rasën emërore pa parafjalë mund të jetë kryefjalë, ndajshtim dhe pjesë e kallëzuesit emëror;
- bën pyetjen: *Me çfarë parafjalësh përdoret rasa emërore?*;
- jep për analizë disa fjali të thjeshta, ku rasa emërore me parafjalë tregon *vend, shkak, kohë, sasi, krahasim* etj.;
- rithekson se emri në rasën emërore me parafjalët *nga, tek* tregon: *vend, shkak, kohë, sasi, krahasim* etj.;
- ndjek të njëjtën procedurë për të gjitha rasat që mësuesi e gjykon të arsyeshme. E rëndësishme është që nxënësit të përforcojnë njohuritë kryesore për funksionin e rasave dhe të dinë t'i gjejnë ato në tekste të ndryshueshme e t'i përdorin drejt ato;
- jep ushtrime lidhur me përdorimin e rasave *me* dhe *pa parafjalë*.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë reklamën në fillim të mësimi 9 në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjet: *Kujt i drejtohet reklama? Kush është porositi i reklamës? Cili është synimi i reklamës?*
- vijon me pyetjet: *Cilat fjalë ndryshojnë sipas rasave? Gjeni fjalët e pandryshueshme. Në ç'rasë është përdorur emri **hotel**? Cili është funksioni i tij? Cila fjalë ju ka ndihmuar për të gjetur funksionin?*
- nxirret përfundimi se fjalët që e ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali janë fjalë të ndryshueshme, se emrat janë fjalë të ndryshueshme, se format e ndryshme që merr emri në fjali, quhen *rasa*, se rasat e emrit janë *me* dhe *pa parafjalë*;
- kërkon të lexojnë fjalitë: *Surprizë, befasi në Ulqin. „Adriatiku”, një hotel i ri i sapondërtuar në bregdet*;
- bën pyetjet: *Çfarë kategorie gramatikore i përkasin fjalët me ngjyrë të zezë? Në çfarë rase janë emrat me ngjyrë të zezë? Për se shërben fjala **në** e vendosur para tyre? Cilës kategori gramatikore i përket ajo? Çfarë tregojnë emrat **Ulqin** dhe **bregdet** të paraprirë nga parafjala **në**?*
- nxirret përfundimi se parafjalët lidhin një fjalë me një tjetër dhe ndihmojnë për saktësimin e mendimit.

Ora e tretë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë fjalitë në vijim që kanë fjalë të paraprirë nga parafjala *për*;
- bën pyetjet: *Cilës kategori gramatikore i përkasin fjalët me ngjyrë të zezë? Përse shërben fjala **për** e vendosur para tyre? Cilës kategori gramatikore i përket fjala **për**? Si quhen grupet e fjalëve të paraprirë nga një parafjalë?*;
- nxirret përfundimi se parafjalë marrin *emrat, përemrat, numërorët dhe ndajfoljet*. *Emrat, përemrat, numërorët dhe ndajfoljet të paraprirë nga parafjalë, quhen ndërtime me parafjalë*;
- kërkon të lexojnë fjalitë që përmbajnë emrat *shkollë* e *motër* të paraprirë nga parafjalë të ndryshme;
- bën pyetjet: *Gjeni ndërtimet me parafjalë? Çfarë kuptimi ka secili prej tyre? Si janë ndërtuar ato? Në çfarë rase janë emrat e paraprirë nga parafjalët? A janë të njëjta ose të ngjashme kuptimet e tyre?*;
- nxirret përfundimi se parafjalët përdoren kryesisht me rasat *kallëzore* dhe *rjedhore*, se me rasën *emërore* përdoren vetëm parafjalët *te(k)* dhe *nga*, se ndërtimet me parafjalë mund të kenë kuptime të njëjta ose të ngjashme (kuptimi *i vendit* në shembujt e dhënë);
- kërkon të lexojnë fjalitë me parafjalën nga (*Ardiani qante nga inati ...*);
- bën pyetjet: *Cilat janë ndërtimet me parafjalë? Si janë ndërtuar ato? Në çfarë rase janë emrat e paraprirë nga parafjalët? Çfarë kuptimi ka secili prej tyre? A janë të njëjta ose të ngjashme kuptimet e tyre?*;
- nxirret përfundimi se parafjalët mjaft herë kanë shumë kuptime, se e njëjta parafjalë mund të përdoret për të shprehur kuptime të ndryshme, se një emër në rasën emërore i prirë nga parafjala nga ka kuptime *shkakore, vendore kohore, kundrinore* etj.;
- kërkon të lexojnë fjalitë në vijim që përmbajnë parafjalët *për arsye, për shkak*;
- bën pyetjet: *Çfarë tregojnë parafjalët për arsye dhe për shkak (nga shkaku) në këto dy fjali? A ka ndonjë ndryshim ndërmjet tyre? Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet*;
- nxirret përfundimi se parafjalët *për arsye* dhe *për shkak (nga shkaku)* tregojnë shkak dhe mund të merren si sinonime dhe se kuptimi i shkakut tek e dyta është më i fortë, sepse ka në përbërjen e saj fjalën *shkak*;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-6 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 10

Lajmi

Synimi: të përforcojnë nxënësit njohuritë lidhur me lajmin, të dallojnë lajmin objektiv nga lajmi subjektiv dhe të shkruajnë vetë lajme.

Janë të nevojshëm: dy lajme të regjistruara nga radioja ose televizioni në magnetofon, një lajm objektiv dhe një subjektiv.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- duke u nisur nga njohuritë e fituara deri në klasën e tetë bën pyetjet: *Çfarë është lajmi? Cilave pyetje u përgjigjet lajmi? Ku dallohet lajmi objektiv nga lajmi subjektiv?*;
- udhëzon nxënësit të dëgjojnë lajmet e regjistruara që ka përgatitur, njëri objektiv dhe tjetri subjektiv;
- kërkon të thonë se çfarë dallimesh vënë re në mes lajmit të parë dhe të dytë;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin “Besa” ekipi më i mirë i vitit;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? A është teksti objektiv apo subjektiv? Kërkon nga nxënësit t’i argumentojnë përgjigjet me të dhëna nga teksti;*
- kërkon të gjejnë në tekst përgjigjet e pyetjeve: *kush, çfarë, ku, kur,* dhe vijon me pyetjet: *Cilës formë të stilit publicistik i përket ky tekst? Cilat janë karakteristikat e kësaj forme të të shprehurit? Kërkon të argumentojnë pohimin se për këtë formë të stilit publicistik ka rëndësi aktualiteti;*
- nxirret përfundimi se teksti “Besa” ekipi më i mirë i vitit... është lajm objektiv, se ai karakterizohet nga saktësia dhe nga vërtetësia e të dhënave, se autori jep të dhëna të sakta për ngjarjen, shënon çdo gjë, por pa përmendur veten (sepse nuk është pjesëmarrës në ngjarje) dhe pa paraqitur mendimet dhe ndjenjat e veta lidhur me ngjarjen, se lajmi objektiv është i pranishëm në gazeta, në radio e televizion, në enciklopedi, në fjalorë, në tekste mësimore, në shkollë, në polici, në gjykatë, në punë etj., domethënë, kudo ku është e nevojshme të konfirmohet vërtetësia e një ngjarjeje;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-3 në *Fletoren e punës*;
- jep detyrë shtëpie të zgjedhin një lajm nga gazetatat ose revistat, ta sjellin në klasë dhe të thonë pse e kanë zgjedhur pikërisht atë. Shkruajnë një lajm lidhur me një ngjarje të ditëve të fundit në shkollën ose në qendrën e tyre të banimit.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 11

Reportazhi

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e reportazhit dhe të aftësohen të shkruajnë vetë reportazhe të shkurta.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin *Në Dhrovjan, në fshatin e ish-presidentit grek në Librin e nxënësit*;
- thotë se teksti që kanë lexuar është reportazh dhe bën pyetjet: *Ç'ndjenja ka zgjuar tek ju? Kush është Pavllo Taçi? Pse flet për të autori i reportazhit? Pse autori i reportazhit shkruan: ... fshati duket gati i braktisur nga jeta. Një heshtje e thellë dhe e rëndë mbizotëron ... I vetmi njeri energjik këtu është kryeplaku i fshatit.... Cila është ideja kryesore e reportazhit? Kërkon të gjejnë fjalët që e shprehin idenë kryesore;*
- vijon me pyetjet: *A është autori në plan të parë në këtë reportazh? Ç'formë rrëfimi ka përdorur autori? Kur është botuar ky reportazh? A ka rëndësi për ju? Kërkon ta shpjegojnë përgjigjen;*
- kërkon të lexojnë tekstin *Ismail Kadare në Munih të Gjermanisë*;
- bën pyetjet: *Përse flitet në këtë reportazh? Kush është Ismail Kadare? Pse autori i reportazhit ka vendosur të shkruajë për të?;*
- pasi thotë se ndryshimi ndërmjet këtij reportazhi dhe reportazhit "*Në Dhrovjan, fshatin e ish-presidentit grek*" është i dukshëm, kërkon ta vërtetojnë këtë gjë me të dhëna nga teksti;
- vijon me pyetjet: *Ç'forma rrëfimi ka përdorur autori: portretizimin, përshkrimin, dialogun, rrëfimin? Pse nuk ka portretizime?*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin *Çfarë është reportazhi* në Librin e nxënësit dhe organizon diskutimin për të;
- gjatë diskutimit tregon kujdes të dalë qartë se reportazhi (nga ang. *reporter, njoftoj, raportoj, lajmëroj*) është forma e stilit publicistik, në të cilën flitet për fatin e njerëzve në mënyrë të dokumentuar, se cilësia e reportazhit varet nga interesi që paraqet tema dhe nga mënyra e trajtimit të saj;
- duke u nisur nga teksti i mësipërm, kërkon nga nxënësit të hartojnë një skicë për reportazhin duke iu përgjigjur pyetjeve: *Ç'është reportazhi? Nga se varet cilësia e reportazhit;*
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-2 në *Fletoren punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 12

Stili publicistik

Synimi: të mësojnë nxënësit veçoritë e stilit publicistik dhe të aftësohen në leximin dhe kuptimin e teksteve të shkruara në këtë stil.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstet: *Çmimi "Nobeli" për ekonomi e mbylli javën e çmimere "Nobeli" dhe Letërsi; çmimi "Nobel" për francezin Le Clezio;*
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këto dy tekste? Kujt i drejtohen ato? Çfarë bëjnë autorët në këto dy tekste? Si është gjuha e këtyre dy teksteve? A është autori pjesëmarrës i ngjarjes? Çfarë janë ato: intervista, reportazhe, lajmërimi, lajme, njoftime? Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;*
- nxirret përfundimi se të dy tekstet i përkasin stilit publicistik (janë njoftime), se për stilin publicistik janë të rëndësishme saktësia dhe vërtetësia e të dhënave dhe se këto veçori e afrojnë stilin publicistik me stilin shkencor, se për stilin publicistik është e rëndësishme edhe saktësia, kuptueshmëria dhe thjeshtësia e të shprehurit;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-2 në *Fletoren e punës.*

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë tekstin *Çfarë është stili publicistik* në Librin e nxënësit dhe organizon diskutimin për të;
- tregon kujdes gjatë diskutimit që të dalë qartë se stili publicistik është mënyra e të shkruarit që përdoret në gazeta, se karakteristikat e stilit publicistik janë: *vërtetësia e të dhënave, saktësia, thjeshtësia dhe kuptueshmëria e parashtrimit të tyre, korrektësia, saktësia e strukturave gjuhësore dhe saktësia drejtshkrimore.*
- kërkon, duke u nisur nga teksti i mësipërm, të hartojnë një skicë për stilin publicistik ku duhet t'u përgjigjen pyetjeve: *Ç'është stili publicistik? Cilat janë veçoritë e tij;*
- u kërkon të bëjnë ushtrimet nr.3-5 në *Fletoren punës.*

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 13

Lutja ose kërkesa zyrtare

Synimi: të njohin nxënësit qëllimin dhe rëndësinë e teksteve të shkurtra zyrtare (lutja ose kërkesë zyrtare), të zhvillojnë aftësinë e shkrimit të pavarur të teksteve të tilla.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë është letra zyrtare, se ku dallohet ajo nga letra jozyrtare. Kërkon të shkruajnë së bashku me shokun ose shoqen e bankës një letër të shkurtër zyrtare drejtuar p.sh. drejtorit të një institucioni, të bibliotekës, teatrit, muzeut, galerisë, me qëllim që t'u japë mundësi ta vizitojnë atë;
- kërkon të veçojnë elementet prej të cilave përbëhet letra zyrtare;
- nxirret përfundimi se letra zyrtare përmban: adresën e dërguesit, adresën e marrësit, datën, formulën e hyrjes, zhvillimin ose përmbajtjen, formulën e përshëndetjes, nënshkrimin, emrin;
- kërkon të lexojnë tekstin me titull *Lutje ose kërkesë për dublikatë të dëftesës*;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon këtë tekst? Çfarë të dhëna jepen për dërguesin? Kuja ia dërgon? Çfarë të dhënash jepen për marrësin? Çfarë i kërkon dërguesi marrësit? Për çfarë arsyeje e kërkon? Çfarë është ky tekst?* Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet me të dhëna nga teksti;
- kërkon ta krahasojnë këtë tekst me tekstin e letrës zyrtare që kanë shkruar në fillim të orës së mësimi dhe të thonë se çfarë ngjashmëri dhe dallimesh kanë ato;
- nxirret përfundimi se lutja ose kërkesa zyrtare është teksti që i dërgojmë një institucioni ose një përfaqësuesi të tij, me qëllim që të na ndihmojë për diçka, se arsyeja më e shpeshtë e shkrimit të një lutjeje ose kërkesë është për të marrë një dokument (vërtetim, dëshmi, dëftesë), për t'u regjistruar në shkollë a në fakultet, për të siguruar një punë, një bursë, një banesë etj., se lutja ose kërkesa duhet të jetë e shkurtër dhe e saktë, me qëllim që të kuptohet çfarë dhe ç'gjë kërkohet me të, se në lutje shënohen të dhënat për dërguesin, për vendin dhe datën e dërgimit, të dhënat për marrësin, për adresën e tij, se në përmbajtjen e kërkesës duhet të shënohet ajo që kërkohet dhe dokumentet që do të dorëzohen bashkëngjitur. Është e domosdoshme që në lutje ose kërkesë zyrtare të vihet nënshkrimi i personit që dërgon lutjen, numri i telefonit dhe adresa elektronike ose e-mail-i;
- kërkon të thonë se ku ndryshon letra zyrtare nga lutja ose kërkesa zyrtare;
- nxirret përfundimi se elementet përbërëse të letrës zyrtare dhe të lutjes ose kërkesës zyrtare janë të ngjashme. Megjithatë, lutja ose kërkesa zyrtare është dokument juridik, i cili duhet të shkruhet patjetër sipas një procedure të caktuar juridike.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet nxënësit se prej çfarë elementesh përbëhet lutja ose kërkesa zyrtare dhe kërkon të shkruajnë në grupe një lutje ose kërkesë zyrtare. Grupeve mund t'u jepet detyrë që të shkruajnë një lutje: *1. për t'u regjistruar në shkollën e mesme, 2. për të dhënë provimin që ka mbetur, 3. për të fituar një bursë nga ndonjë institucion, 4. për të dhënë provimin e pranimit (në një shkollë artistike, për shembull)*. Çdo nxënës i grupit duhet të shkruajë një pjesë të lutjes. Grupet prezentojnë pastaj atë që kanë bërë. Është mirë që në fund të kontrollohet veçmas respektimi i rregullave drejtshkrimore në shkrimin e lutjes zyrtare;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 14

Stili administrativ

Synimi: të aftësohen nxënësit për të lexuar e kuptuar tekste profesionale të shkruara me stilin administrativ, si edhe të aftësohen për të shkruar në mënyrë të pavarur tekste të tilla.

Janë të nevojshëm: Fjalorë të gjuhës shqipe ose fotokopje të faqes 3 të *Fjalorit të shqipes së sotme*.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Fjalorin e shqipes së sotme* ose në faqet e fotokopjuara prej tij kuptimet e fjalëve: *administratë, administrativ, administrativisht, administrator, administrim, ministroj, ministrues*. Organizon diskutimin për to;
- thotë të lexojnë në Librin e nxënësit ligjin *Për mbrojtjen e mjedisit*;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Teksti është shkëputur nga: a) një vepër letrare, b) një artikull gazete, c) një dokument zyrtar?* Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- vijon me pyetjet: *Cili është qëllimi i këtij teksti? A mund ta thoni me fjalët tuaja përmbajtjen e tekstit? Çfarë lloj fjalësh janë mbizotëruese? Në këtë tekst fjalitë janë të gjata. Çfarë është arritur me këtë gjë?*
- nxirret përfundimi se teksti është shkruar në stilin administrativ;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* vërtetimin në vazhdim;
- bën pyetjet: *Kujt i lëshohet ky vërtetim? Përse shërben ai?* Kërkon të gjejnë foljet në tekstin e vërtetimit dhe të thonë formën, vetën, kohën e tyre, si edhe t'i argumentojnë përgjigjet;
- nxirret përfundimi se teksti është shkruar në stilin administrativ;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit *Kërkesë për bursë* në vazhdim;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon këtë tekst? Çfarë fjale përdor për t'u prezentuar? Kujt ia dërgon? Çfarë i kërkon dërguesi marrësit? Çfarë është ky tekst?* Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet me të dhëna nga teksti;
- kërkon ta krahasojnë këtë tekst me tekstin e mëparshëm dhe të thonë se çfarë ngjashmëri dhe dallimesh kanë ato, a ka ndonjë shprehje në këtë tekst të cilën nuk do të mund ta përdornim në komunikimin e përditshëm. Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- nga analiza e tre teksteve duhet të nxirret përfundimi se tekstet që kanë lexuar janë shkruar me stilin administrativ, se me stilin administrativ shkruhen dokumentet zyrtare: *ligjet, rregulloret, lutjet, ankesat, paditë, informacionet, prokurat, formularët*, se në këtë stil duhet të zbatohen rregulla të përcaktuara, se për këtë stil është me rëndësi që të shprehurit të jetë i saktë, në mënyrë që të mos krijohen keqkuptime në kuptimin e dokumentit, se stili administrativ karakterizohet nga shprehjet e ngulitura, nga fjalitë e gjata, nga varfëria e mjeteve gjuhësore, nga mungesa e ndjeshmërisë, se në tekstet e stilit administrativ mbizotërojnë emrat dhe se foljet janë më shpesh në kohën e tashme. Duhet theksuar se nuk është mirë që të përdoren shprehjet karakteristike për këtë stil në situata të tjera gjuhësore;
- kërkon të thonë se çfarë stili i përket teksti në vazhdim dhe ta argumentojnë përgjigjen me të dhëna nga teksti;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 15

Emrat foljorë

Synimi: të mësojnë nxënësit se çfarë janë e si formohen emrat foljorë dhe të aftësohen t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejtë ato.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit: *Neni 5, Elementet e mbrojtjes së mjedisit*;
- bën pyetjen: *Përse flitet në këtë tekst? Thotë se ky tekst është shkruar në stilin administrativ. Bën pyetjet: Çfarë pjese e ligjëratës mbizotëron në këtë tekst? Çfarë tregojnë emrat me shkronja të zeza? Prej cilave folje janë formuar emrat me shkronja të zeza? Si quhen emrat e formuar prej foljeve? Cilat emra janë formuar nga foljet **ul, ruaj**? Si është formuar emri **ndotje**? Cila është prapashtesa? Cilat janë prapashtesat tek fjalët: **përdorimi, riaftësimi, shmangia, përmirësimi**?*
- nxirret përfundimi se emrat që formohen nga foljet dhe që tregojnë zakonisht procesin e veprimit janë emra *foljorë*, se emrat foljorë ndërtohen kryesisht duke i shtuar prapashtesën *-im* dhe *-je* temave foljore, se këto dy prapashtesa janë sinonimike me njëra-tjetrën për nga kuptimi;
- kërkon që të lexojnë emrat që mbarojnë me mbaresat *-im, -je*;
- bën pyetjet: *Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së parë? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve? Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së dytë? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve?*;
- nxirret përfundimi se prapashtesa *-im* bashkohet zakonisht me folje që mbarojnë me *-oj*, dhe *-ej* dhe se prapashtesa *-je* bashkohet me të gjitha foljet e tjera, përjashtuar ato me *-oj, -ej*;
- kërkon të lexojnë emrat që mbarojnë me mbaresat *-esë, -imë, -atë, -më*;
- bën pyetjet: *Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së parë? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve? Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së dytë? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve? Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së tretë? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve? Nga cilat folje janë formuar emrat e kolonës së katërt? Çfarë prapashtese i është shtuar temës së foljeve?*;
- nxirret përfundimi se emrat foljorë që tregojnë proces veprimi formohen edhe me prapashtesa më pak produktive, si: *-esë, -atë, -më, -imë*, se emrat me prapashtesat *-esë, -atë* shënojnë kryesisht rezultatin e veprimit.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë fjalitë në vijim dhe pyet se cilat nga këto fjali tingëllojnë më bukur dhe më natyrshëm;
- nxirret përfundimi se në gjuhën standarde shqipe, me përjashtim të stilit administrativ, nuk rekomandohet përdorimi i emrave foljorë, se folja, si kallëzues, është pjesa kryesore e fjalisë, se ajo tregon veprimin e kryer nga kryefjala, prandaj në raste si ato të fjalive që do të analizohen, është më mirë të përdoret folja në vend të emrit;
- kërkon të gjejnë emrat foljorë në tekstin në vazhdim në Librin e nxënësit dhe, në varësi të kohës që kanë në dispozicion, të bëjnë dhe komentet përkatëse;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 16

Plotësojmë formularë

Synimi: të lexojnë e të kuptojnë nxënësit formularët bankarë, postarë etj. dhe të mësojnë t'i plotësojnë ato.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- bën pyetjet: *Çfarë është telegrami? Çfarë është fletëpagesa? Kur plotësojmë fletëpagesa? Organizon diskutimin mbi bazën e tyre;*
- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit *Fletëporosinë;*
- bën pyetjet: *Çfarë është ky tekst? Me këtë fletëporosi mund: a) të porositet një nga objektet e ofruara, b) të porositen disa objekte, c) të bëhet pagesa për revistën? Kush e ka përgatitur? Kush e ka plotësuar? Çfarë ka porositur Skendëri? Si janë shënuar objektet që ka porositur Skenderi? Cilin objekt mund të mos e kishte shënuar? Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet. Vijon me pyetjen: Çfarë tjetër duhet plotësuar, që porositësit t'i arrijë ajo që ka porositur?*
- kërkon të lexojnë formularin e tekstit *Kërkesë për marrjen e vizës;*
- bën pyetjet: *Ku bëhet kërkesa për vizë? Kush e ka bërë këtë kërkesë? Në cilin shtet dëshiron të udhëtojë personi që e ka bërë këtë kërkesë? Cilat të dhëna i ka shkruar në dy forma? Pse personi që e ka bërë këtë kërkesë nuk u është përgjigjur pyetjeve numër 18 dhe 27? Kush nuk duhet t'i plotësojë rubrikat e shënuara me*? Pse personi që e ka bërë këtë kërkesë e ka plotësuar këtë rubrikë? Ç'pasoja do të kishte ai që e ka bërë kërkesën, nëse ajo nuk do të ishte plotësuar saktë dhe si duhet? Për çfarë arsyeje të dhënat që shkruajmë, duhet të jenë të sakta dhe të plota?*
- nxirret përfundimi se formularët duhen plotësuar duke i shkruar qartë, saktë dhe pa korrigjime të dhënat e kërkuara në çdonjërin nga rubrikat e formularit. Në disa fletëporosi, ajo që kërkohet shënohet me një shenjë të veçantë;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-2 në *Fletoren e punës.*

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 17

Gjuha letrare ose standarde

Synimi: të mësojnë nxënësit se çfarë përfshin norma e gjuhës standarde. Nuk është e domosdoshme që nxënësit t'i thonë ato me radhë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit katër tekstet e dhëna;
- bën pyetjen: *Në cilin stil është shkruar secili prej këtyre teksteve?* Kërkon ta argumentojnë përgjigjen me të dhëna nga teksti;
- vijon me pyetjet: *Cilat rregulla drejtshkrimore janë zbatuar në shkrimin e disa emrave me shkronjë të madhe në tekstin e parë? Në çfarë kohe janë foljet në tekstin e dytë? Pse? Në çfarë kohe janë foljet në tekstin e tretë? Pse? Në tekstin e katërt, si mund të thuhet ndryshe fjalia: Të marrë pjesë në veprimtaritë e shkollës?* Thotë të bëjnë komentet e tyre për këto dy mënyra përdorimi;
- nxirret përfundimi se tekstet e mësipërme u përkasin stileve të ndryshme, *publicistik, shkencor, letrar-artistik dhe administrativ*, por se të gjithë ato janë në *gjuhën letrare ose standarde*, se gjuha letrare ose standarde shqipe është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, se ajo përdoret në shkollë, në shkencë, në media, në teknikë, në gazetari, në kulturë, në letërsi, në administratë dhe në format e tjera të komunikimit publik, se karakteristika e saj kryesore është *normimi*, d.m.th. pranimi dhe zbatimi nga të gjithë i disa rregullave mbi bazën e të cilave ajo funksionon, se norma përfshin të gjitha nivelet e gjuhës, *drejtshqiptimin, drejtshkrimin, gramatikën dhe fjalorin*;
- kërkon të lexojnë tekstet brenda kuadrateve dhe të lidhin me shigjetë rregullin me normën së cilës i përket;
- nxirret përfundimi se normat e gjuhës standarde janë rregullat e shqiptimit, e shkrimit, e formave të fjalëve, e strukturës së fjalisë, e përdorimit të fjalëve, si edhe rregullat stilistike; se rregullat e gjuhës standarde janë të përcaktuara në drejtshkrim, në gramatika dhe në fjalorë;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-6 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 18

Variante gjuhësore joletrare ose jostandarde

Synimi: të gjejnë nxënësit në tekste fjalë, forma fjalësh dhe shprehje gjuhësore standarde e jostandarde.

Janë të nevojshme: dy regjistrime me magnetofon, një në gjuhën letrare ose standarde dhe një gjuhën joletrare ose jostandarde.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fton nxënësit të dëgjojnë me vëmendje regjistrimet në magnetofon dhe kërkon të thonë, nëse janë apo nuk janë në gjuhën letrare ose standarde. Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- u kërkon të lexojnë bashkëbisedimin e parë në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjen: *Në këtë tekst është përdorur: a) gjuha letrare ose standarde, b) gjuha joletrare ose jostandarde?* Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- kërkon të lexojnë bashkëbisedimin e dytë në *Librin e nxënësit*;
- bën pyetjet: *Në këtë tekst është përdorur: a) gjuha letrare ose standarde, b) gjuha joletrare ose jostandarde? Mbi ç'bazë e nxjerr këtë përfundim?* Kërkon të gjejnë fjalët e përdorura në gjuhën jostandarde;
- bën pyetjen: *Ç'përfundim mund të nxjerrësh për kulturën e të folurit të bashkëbiseduesve?* Kërkon ta shkruajnë dialogun në gjuhën letrare;
- nxirret përfundimi se çdo moszbatim i rregullave të gjuhës letrare ose standarde konsiderohet si formë e të shprehurit joletrar ose jostandard;
- kërkon të lexojnë tekstin e marrë nga Interneti;
- thotë se ky tekst nuk është në përputhje me normat e gjuhës letrare ose standarde. Kërkon ta vërtetojnë këtë gjë me të dhëna nga teksti;
- bën pyetjen: *Ç'përfundim mund të nxirrni për kulturën gjuhësore të hartuesit të këtij teksti?* Kërkon ta shkruajnë tekstin në gjuhën letrare ose standarde;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-2 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 19

Ligjërimi bisedor

Synimi: të mësojnë nxënësit se çfarë është ligjërimi bisedor dhe cilat janë veçoritë e tij.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të improvizojnë një bisedë telefonike;
- analizojnë bisedën dhe arrijnë në përfundimin se biseda është në ligjërimin bisedor, sepse ka lëkundje ose moszbatim të normave fonetike, gramatikore, leksikore, sintaksore;
- kërkon të lexojnë dy tekstet në vazhdim;
- bën pyetjet: *Përse flitet në tekstin e parë? Cilët janë bashkëbiseduesit? Thotë se teksti i parë është ligjërime bisedor. Kërkon nga nxënësit që ta argumentojnë këtë pohim;*
- vijon me pyetjet: *Çfarë dallimesh me normën e shqipes standarde vini re në gjuhën e këtij teksti? Përse flitet në tekstin e dytë dhe cilit stil i përket? Teksti i dytë është: a) në gjuhën standarde, b) në gjuhën jostandarde?;*
- nxirret përfundimi se teksti i parë është në ligjërimin bisedor, se ai karakterizohet nga lëkundje të normës, se ka ndikime dialektore e krahinore që janë brenda kufijve të gjuhës letrare ose standarde, se ligjërime bisedor përdoret në komunikimin e përditshëm, më shpesh gjatë komunikimit gojor dhe në dialog, se, duke pasur parasysh se pjesëmarrësit e dialogut janë në kontakt të drejtpërdrejtë, kuptimi transmetohet gjatë dialogimit edhe me gjeste dhe me mimikë dhe jo vetëm me fjalë, se ligjërime bisedor dallohet prej stileve funksionale pasi është kryesisht gojor, jozyrtar dhe ka mënyrën e të shprehurit me ndikime dialektore, se ligjërime bisedor zakonisht është spontan dhe nuk ka rregulla të përcaktuara që duhet të zbatohen;

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin që flet për *Disa veçori të ligjërimin bisedor* dhe të bëjnë komentet përkatëse lidhur me të;
- kërkon të lexojnë tekstet e një forumi në Internet;
- bën pyetjet: *Cila është tema e këtij forumi? Kush e ka filluar diskutimin? Si i ka lindur ideja? Kur ka filluar dhe kur ka përfunduar biseda në forum? A janë këto emrat e vërtetë të pjesëmarrësve në forum? A përdoret në forum: a) gjuha zyrtare, b) gjuha jozyrtare? Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet e tyre;*
- vijon me pyetjet: *Cila shkronjë nuk përdoret në forum? Nga cila shkronjë zëvendësohet? Si bisedojnë pjesëmarrësit në forum: a) nuk njihen, kështu që biseda është zyrtare, b) njihen, kështu që biseda është jozyrtare, c) edhe pse nuk njihen, biseda është jozyrtare? A zbatohen normat drejtshkrimore dhe gramatikore? Kërkon t'i argumentojnë përgjigjet;*
- bën pyetjet: *A ka fjalë të huaja ose joletrare? Cilat janë ?*
- nxirret përfundimi se format me shkrim të ligjërimin bisedor janë letërkëmbimet jozyrtare, posta elektronike personale, forumet në Internet etj.;
- kërkon që fjalitë në vijim që janë të ligjërimin bisedor, t'i shkruajnë në shqipen standarde, si edhe të shkruajnë me disa fjali kur përdoret ligjërime bisedor, cilat janë karakteristikat e tij dhe ç'elemente ka një bisedë tipike;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-3 në Fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Punë e pavarur

RUAJTJA E MJEDISIT

Synimi: të zbatojnë nxënësit atë që kanë mësuar për stilet funksionale. Teksti që do të shkruajnë duhet të jetë rezultat i punës së tyre kërkimore.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- porosit paraprakisht nxënësit të mbledhin materiale për këtë temë nga enciklopeditë, nga tekstet mësimore, nga interneti, nga gazetatat etj.
- ndan nxënësit në pesë grupe;
- për t'u përgatitur kanë në dispozicion 20 minuta. Kërkon t'i shkruajnë e unifikojnë sipas grupeve në letër hamer ose në një fletë të madhe të dhënat më të rëndësishme që kanë grumbulluar;
- var në dërrasë të zezë ose në mur fletën e letrës hamer;
- dy nxënës të çdo grupi prezantojnë punën e grupit të vet. Kësaj pjese të punës nuk duhet t'i kushtojmë shumë kohë, sepse stenda do të mbetet në klasë gjithnjë deri në përfundimin e punës projektuese, kështu që nxënësit do të mund të lexojnë edhe më pas atë që u intereson.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- çdo grup do të trajtojë temën për ruajtjen e mjedisit në stile të ndryshme;
- grupi I do ta trajtojë temën në stilin *publicistik*. Nxënësit duhet të kenë parasysh se teksti i kushtohet një rrethi të gjerë lexuesish, prandaj nuk duhet të përdoren me tepri termat profesionale;
- grupi II do ta trajtojë temën në stilin *shkencor*. Ky grup përveç të dhënave tashmë të mbledhura, mund të kërkojë informacionet shtesë të nevojshme për ta shkruar tekstin;
- grupi III do ta trajtojë temën në stilin *administrativ*. Ky grup ka për detyrë të "kopjojë" disa rregulla "ligjore" për ruajtjen e ambientit. "Rregullat" që do të shkruajnë nxënësit mund të kenë të bëjnë me ruajtjen e pastërtisë së ujërave, të pyjeve, të ajrit etj.;
- grupi IV do ta trajtojë temën në stilin *letrar-artistik*. Ky grup ka për detyrë të shkruaj një tekst artistik, në të cilin në mënyrë të figurshme, duke përdorur mjetet e gjuhës poetike, do ta paraqesin problemin e ruajtjes së mjedisit. Ata mund të shkruajnë një vjershë, tregim, përrallë, fabul, satirë... .
- grupi V do ta trajtojë temën në ligjërimin *bisedor*. Ky grup ka për detyrë të shkruaj tekstin duke përdorur ligjërimin bisedor.

Ora e tretë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- të gjithë grupeve u thotë të përgatitin stendat, të cilat mund t'i ilustrojnë me fotografi, vizatime, parulla (nëse këtë gjë e lejon stili). Stendat duhet të vendosen në një vend të dukshëm në klasë;
- kërkon nga çdo grup të informojë për punën e vet dhe të shpjegojë karakteristikat e stilit funksional që kanë përdorur në punën e vet;
- kërkon nga nxënësit e tjerë që të bëjnë pyetje ose komente për punën e grupit.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 20

Njoftimet publike

Synimi: të aftësohen nxënësit të lexojnë e të kuptojnë njoftimet publike, si edhe të shkruajnë vetë njoftime publike.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* shkrimet e shoqëruara me figura në hyrje të mësimi;
- bën pyetjen: *Cili prej teksteve të dhëna është reklamë?* Kërkon ta shpjegojnë përgjigjen. Thotë të gjejnë midis njoftimeve të dhëna njoftimin personal dhe të shpjegojnë pse është i tillë;
- vijon me pyetjen: *Ç'të dhëna duhet të përmbajë njoftimi publik?* Kërkon t'i gjejnë ato në njoftimet e dhëna;
- kërkon të lexojnë njoftimin për *Internacional Party*;
- bën pyetjet: *Për cilën ngjarje flitet në tekst? Mbi ç'bazë e nxirrni këtë përfundim? Kur ka ndodhin kjo gjë? Teksti është: a) ftesë, b) reklamë, c) njoftim?* Kërkon ta shpjegojnë përgjigjen.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- vijon me analizën e teksteve të tjera dhe me pyetjet e parashikuara për to në *Librin e nxënësit*;
- nxirret përfundimi se në njoftimet publike përfshihen: njoftimet nga fusha e kulturës dhe e sportit, parashikimi i motit, numërori telefonik, menyja, orari i udhëtimeve, orari i punës, programi i radios dhe i televizionit, lajmërimet e vdekjes etj., se njoftimet publike publikohen më shpesh në gazeta, në radio, në televizion, në tabelat e afisheve, në telefonin celular ose në e-mail. Nxënësit duhet të kuptojnë pse është njoftim harta dhe të mësojnë se si përdoret ajo;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-8 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 21

Shkrimi i fjalëve me vizë në mes

Synimi: të mësojnë nxënësit përdorimin e vizës në fjalët që fillojnë me numërorë ose që shënojnë caqe gjeografike apo kohore ose në mes të dy a më shumë fjalëve që janë emra me marrëdhënie të ndërsjella.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* njoftimin dërguar Astritit;
- bën pyetjet: *Cili është qëllimi i këtij njoftimi? Pse organizohet kjo veprimtari? Si është shkruar emërtimi i përvjetorit të shkollës? A mund të shkruhet ndryshe? Si?*
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin për përvjetorët;
- bën pyetjet: *Si janë shkruar emërtimi i përvjetorëve në këtë njoftim? A mund të shkruhen ndryshe? Si?*
- nxirret përfundimi se emërtimet e përvjetorëve shkruhen me vizë në mes kur numërori shënohet me shifër, ndërsa kur numërori shkruhet me shkronja, fjala shkruhet si një e vetme dhe pa vizë në mes;
- kërkon të lexojnë grupet e fjalëve në vijim;
- bën pyetjet: *Çfarë shënojnë emrat me të zeza (Podgoricë-Tiranë-Korçë..., janar-maj...) në kuadratin e parë? Si janë shkruar ato? Çfarë shënojnë numrat me të zeza (1941-1945;..., XIX-XX...) në kuadratin e dytë? Si janë shkruar ato? Çfarë shënojnë emrat me të zeza (Deçiq-Buduqnost..., mall-para) në kuadratin e tretë? Si janë shkruar ato?*
- nxirret përfundimi se shkruhen me vizë në mes: a) emrat e përveçëm që shënojnë caqet e një hapësire gjeografike, si edhe emrat që shënojnë caqe kohore; b) numërorët që shënojnë caqet e një hapësire kohore; c) dy a më shumë emra të veçantë që kanë marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet tyre;
- kërkon të shkruajnë tre emërtime përvjetorësh me fjalë dhe me numra;
- kërkon të thonë se çfarë shënojnë emrat me shkronja të zeza: udhëtimi Francë-Argjentinë-Australi, japin shembuj me fjalë të ngjashme: *udhëtimi..., hekurudha..., periudha...,* si edhe të shkruajnë katër shembuj me emra dhe numërorë që shënojnë caqe dhe hapësirë kohore;
- thotë të vështrojnë dhe të komentojnë përdorimin e vizës në tabelën në vazhdim;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-4 në *Fletoren e nxënësit*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 22

Tregimi

Synimi: të dallojnë nxënësit tregimin dhe veçoritë e tij prej formave dhe veçorive të tjera të rrëfimeve.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të bisedojnë në çifte, se si e kanë kaluar ditën e djeshme dhe të thonë se cilën formë të rrëfimit kanë përdorur gjatë bisedës: a) përshkrimin, b) tregimin në vetën e parë, c) tregimin në vetën e tretë;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin me titull *Zbulohet observatori më i vjetër astronomik në Evropë*;
- bën pyetjen: Teksti është: a) publicistik, b) shkencor, c) artistik? Kërkon nga nxënësit ta argumentojnë përgjigjen;
- kërkon të përcaktojë temën e këtij teksti: a) vjetërsia e observatorit më të madh astronomik, b) zbulimi i observatorit më të madh astronomik, c) përshkrimi i vendit dhe i ambientit ku ndodhet observatori astronomik. Kërkon nga nxënësit ta argumentojnë përgjigjen;
- vijon me pyetjet: *Shprehjet në vijim janë të sakta apo jo të sakta: - observatori më i vjetër astronomik ndodhet në Francë, - Arkeologët nuk mundën të përcaktojnë datën e observatorit astronomik, - vendi arkeologjik i zbuluar ka qenë ndërtuar për të vëzhguar dukuri astronomike të tilla si lëvizjet e Diellit, Hënës, yjeve?* Forma e tregimit që mbizotëron në tekst është: a) përshkrimi, b) tregimi në vetën e parë, c) tregimi në vetën e tretë? Kërkon nga nxënësit t'i argumentojnë përgjigjet;
- vijon me pyetjet: *Qëndrimi ndaj objektit të tregimit është: a) subjektiv, b) objektiv?* Kërkon nga nxënësit ta vërtetojnë këtë gjë me të dhëna nga teksti. *Në tekst përdoret: a) tregimi kronologjik, b) tregimi retrospektiv, c) njëra dhe tjetra? Cilat forma foljore përdoren?*
- Kërkon nga nxënësit të përpiqen t'i zëvendësojnë format e përdorura me format të tjera dhe të thonë nëse është e mundur kjo gjë. Kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- nxirret përfundimi, se të tregosh do të thotë të informosh bashkëfolësin ose lexuesin për një seri ngjarjesh reale ose të imagjinuara, të cilat pasojnë dhe janë të lidhura me njëra-tjetrën, se tregimi, përveç se në letërsi, në publicistikë dhe në historiografi, përdoret edhe gjatë komunikimit të përditshëm, se gjatë tregimit parashtrimi duhet të jetë i kuptueshëm, bindës dhe i qartë për të nxitur interesimin tek lexuesit dhe tek dëgjuesit, se gjatë tregimit, përveç formave foljore të së shkuarës, përdoren edhe format e tjera dhe se shpesh forma e kohës së tashme përdoret për të treguar veprimet e shkuara.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin me titull *Ujku*;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar tekstin? A renditen ngjarjet sipas radhës së zhvillimit të tyre? Forma e tregimit që mbizotëron në tekst është: a) përshkrimi, b) tregimi në vetën e parë, c) tregimi në vetën e tretë?* Kërkon nga nxënësit t'i argumentojnë përgjigjet e tyre;
- vijon me pyetjet: *Qëndrimi ndaj objektit të tregimit është: a) subjektiv, b) objektiv? Cilat stil funksional i përket ky tekst? Cila është tema e këtij teksti? Cilat forma foljore përdoren?* Kërkon prej nxënësve t'i argumentojnë përgjigjet e tyre;

- nxirret përfundimi se të treguarit e ngjarjeve në vetën e parë i jep tregimit të ngjarjes karakter subjektiv, kurse të treguarit e ngjarjes në vetën e tretë i jep tregimit të ngjarjes karakter objektiv;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-3 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 23

Fjalìa e pavetore

Synimi: të mësojnë nxënësit veçoritë fjalive pavetore dhe llojet e tyre.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet nxënësit se çfarë janë fjalitë njëkryegjymtyrëshe, sa lloj fjalish njëkryegjymtyrëshe kemi dhe çfarë janë fjalitë foljore vetore;
- ritheksohet përfundimi se fjalitë e thjeshta janë një ose dykryegjymtyrëshe, se fjalitë njëkryegjymtyrëshe janë emërore dhe foljore, se fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore vetore janë fjalitë që e kanë foljen në vetën e parë ose të dytë, njëjës ose shumës, tek të cilat personi që e kryen veprimin bëhet i qartë nga mbaresat e foljes dhe nga situata e ligjërimit, se fjali foljore vetore janë edhe ato që e kanë foljen në vetën e tretë shumës;
- kërkon nga nxënësit të lexojnë fjalitë: *S'i dihet kësaj pune. Jashtë bënte të ftohtë. Po ngrysej. Më hahet.*;
- bën pyetjet: *Kush e kryen veprimin në këto fjali? Në çfarë vete është folja? Çfarë fjalish foljore janë?* Kërkon nga nxënësit t'i argumentojnë përgjigjet;
- nxirret përfundimi se fjalitë në të cilat kryefjala nuk është e përcaktuar, d.m.th. nuk mund të thuhet me saktësi se kush e kryen veprimin, quhen fjali pavetore ose fjali pa kryefjalë, se fjalitë e tilla ndërtohen me folje ose shprehje foljore pavetore që nuk e kanë kuptimin e vetës, pra, që nuk e kanë të përcaktuar e të shprehur vepruesin, se në këto fjali është i pamundur përdorimi i një emri në funksion të kryefjalës;
- kërkon të lexojnë tre grupet e fjalive në vijim (A, B, C);
- bën pyetjet: *Çfarë tregojnë fjalitë pavetore të grupit A? Çfarë foljesh janë ato të fjalive të grupit A? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit B? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit C? Çfarë fjalish pavetore janë?*
- nxirret përfundimi se fjalitë pavetore janë të llojeve të ndryshme, se ato mund të jenë: fjali të ndërtuara me folje pavetore që tregojnë dukuri të natyrës (A); fjali pavetore të ndërtuara nga një folje kalimtare (*ndodh, qëllon, ngjet, del* etj.) dhe një ndajfolje mënyre (B); fjali pavetore të ndërtuara nga një folje e trajtës joveprore në vetën e tretë njëjës (*flitet, bëhet, punohet, luftohet, dyshohet, jetohet, rrihet* etj.) dhe një rrethanor a kundrinor (C).

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë pesë grupet e fjalive në vijim (A, B, C, Ç, D);
- bën pyetjet: *Çfarë tregojnë fjalitë pavetore të grupit A? Çfarë foljesh janë ato të fjalive të grupit A? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit B? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit C? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit Ç? Çfarë fjalish pavetore janë? Si janë ndërtuar fjalitë e grupit D? Çfarë fjalish pavetore janë?*
- nxirret përfundimi se fjalitë pavetore mund të jenë edhe: fjali pavetore të ndërtuara nga një folje kalimtare e vetës së tretë njëjës e formës joveprore që paraprihet nga një trajtë e shkurtër e dhanores (A); fjali pavetore të ndërtuara nga folje si *jam, vij, bëj, bie, fryn* në vetën e tretë njëjës+një ndajfolje ose një emër (B); fjali pavetore të ndërtuara nga një folje modale+pjesore (C); fjali pavetore të ndërtuara nga folja *jam* në vetën e tretë njëjës+paskajore (Ç); fjali pavetore të ndërtuara nga foljet *mund, duhet, filloj, nis* etj.+folje në lidhore (D).
- kërkon nga nxënësit të shkruajnë një skicë të shkurtër për fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 24

Fjalorët dhe përdorimi i tyre

Synimi: të njohin nxënësit fjalorët dhe veçoritë e përdorimit të tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* faqen e parë të *Fjalorit të shqipes së sotme*;
- bën pyetjet: *Nga cili libër është shkëputur kjo faqe? Përse shërben “Fjalori i shqipes së sotme”? Si renditen fjalët në “Fjalorin e shqipes së sotme”? Çfarë fjalori është ky? Çfarë janë fjalorët dhe përse shërbejnë? Sa lloje fjalorësh njihni ju? Çfarë është fjalori shpjegues? Fjalori i fjalëve të huaja u dedikohet: a) atyre që nuk dinë gjuhë të huaja, b) vetëm atyre që merren me ndonjë shkencë, c) një rrethi të gjerë të përdoruesve? Në fjalorin drejtshkrimor jepen: a) kuptimet e fjalëve, b) fjalët dhe format që ato marrin gjatë përdorimit në fjali? Në fjalorët enciklopedik jepen: a) format e ndryshme të fjalëve, b) kuptimet e fjalëve, c) informacione për ngjarje, vende, personalitete?*
- nxirret përfundimi që fjalor quhet libri që përmban fjalët e një gjuhe ose termat e një fushe të shkencës, të teknikës e të kulturës, se fjalët renditen zakonisht sipas alfabetit dhe shpjegohen ose përkthehen në një gjuhë tjetër a në disa gjuhë, se fjalorët mund të jenë njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh. Fjalorët njëgjuhësh mund të jenë shpjegues, drejtshkrimorë, terminologjikë, të sinonimeve, të antonimeve, të fjalëve të huaja, enciklopedikë, elektronikë etj.
- kërkohet të bëjnë ushtrimet nr. 1- 5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 25

Korrektimi letrar

Synimi: të aftësohen nxënësit të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit dhe njohuritë gjuhësore.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë e të vështrojnë me vëmendje në *Librin e nxënësit* tekstin me korrigjime;
- bën pyetjet: *Çfarë shenjash me ngjyrë të kuqe janë përdorur në tekst? Përse shërbejnë ato? Ç'kuptim ka secili prej tyre? Çfarë gabimesh janë bërë në këtë tekst? Si duhen ndrequr ato?;*
- kërkon të lexojnë tekstin e nxënësit *E kaluara e stuhishme e qytetit* marrë nga Interneti;
- bën pyetjet: *A është i kuptueshëm ky tekst? A është e saktë gjuha e këtij teksti? A janë të sakta formulimet në pjesën e parë të tekstit? A janë të sakta formulime në pjesën e dytë të tekstit?;*
- i jep detyrë çdo nxënësi që të shkruajë sa më të bukur e sa më të qartë një fjali (teksti ka 9 fjali) nga teksti i shkruar në *Librin e nxënësit*, natyrisht duke i korrigjuar gabimet;
- kërkon të shkruajnë fjalinë e dhënë në fletën që i ka dhënë secilit mësuesi/ja. Kur të përfundojnë shkrimin, i ngjitin sipas radhës fjalitë nën njëra-tjetrën në letër hamer, duke plotësuar kështu tekstin;
- kërkon të vlerësojnë se shkrimi i kujt është më i bukur dhe më i qartë dhe të shohin nëse janë ndrequr gabimet;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin e nxjerrë nga shtypi *Mariza shijon kafën e mëngjesit*;
- bën pyetjet: *A është i kuptueshëm ky tekst? A është e saktë gjuha e këtij teksti? A janë të sakta formulimet në këtë tekst? A ka gabime drejtshkrimore? Kërkon nga çdo nxënës që të bëjë korrigjimin e tekstit;*
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 26

Familjet e gjuhëve

Synimi: të mësojnë nxënësit se gjuhët grupohen në familje gjuhësore dhe të mbajnë mend se cilës familje i përket gjuha që ata flasin, në këtë rast shqipja.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fton nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* tabelën për numrin e gjuhëve që fliten në botë;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tabelë? Sa gjuhë fliten sot në botë? Sa gjuhë fliten në Evropë?*;
- nxirret përfundimi se numri i gjuhëve që fliten në botë nuk mund të përcaktohet kurrë me saktësi, se sipas të dhënave të vitit 1996 në botë fliteshin 6703 gjuhë, kurse në Evropë 225 gjuhë, se sipas të dhënave të vitit 2002, në botë fliteshin 6800 gjuhë;
- fton nxënësit të vështrorjnë hartën dhe të thonë sa familje gjuhësore ekzistojnë dhe se cilës familje gjuhësore i përket gjuha shqipe;
- nxirret përfundimi se gjuhët e botës grupohen në familje gjuhësore, se në një familje përfshihen gjuhë me origjinë të përbashkët, se në botë ka disa familje gjuhësore, se një prej tyre është familja indoevropiane që shtrihet në Evropë dhe Azi (Indi, Iran etj.), se gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indoevropiane;
- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* tabelën me fjalë nga gjuhët indoevropiane;
- bën pyetjet: *Si paraqitet fjala **nënë** në shtatë gjuhët e mësipërme? Po fjalët **vëlla, atë, motër** si paraqiten? A kanë ngjashmëri ato nga njëra gjuhë në tjetrën? Si shpjegohen këto ngjashmëri?*;
- nxirret përfundimi se vetëm në shekullin XIX u zbulua se gjuhë krejt të ndryshme, si: *latinishtja, anglishtja, gjermanishtja, rusishtja, persishtja ose shqipja*, kishin shumë ngjashmëri dhe se e kishin origjinën nga e njëjta gjuhë dhe se i përkisnin të njëjtës familje gjuhësore; *indoevropianishtes*. Gjuha shqipe, pra, i përket familjes së gjuhëve indoevropiane;
- kërkon të shohin hartën e gjuhëve indoevropiane;
- bën pyetjet: *Sa degë ka familja e gjuhëve indoevropiane? Cilat janë ato? Cilës degë i përket gjuha shqipe?*
- nxirret përfundimi se gjuhët *indoevropiane* që fliten në Evropë janë: gjuhët *romane* (italishtja, frëngjishtja, spanjishtja etj.), *gjuhët gjermanike* (gjermanishtja, anglishtja, norvegjishtja etj.), *gjuhët sllave* (rusishtja, polonishtja, serbishtja etj.), *gjuhët baltike* (lituanishtja, letonishtja), *gjuhët kelte* (fliten në Irlandë e Skoci), *greqishtja, shqipja* etj., se shqipja formon një *degë më vete* në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe *nuk* ka lidhje *birërie* me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane, se karakteri indoevropian i shqipes u përcaktua dhe u vërtetua nga mesi i shekullit XIX nga dijetari i njohur gjerman *Franc Bop*;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr. 1-4 në *Fletorën e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 27

Historia e gjuhës shqipe

Synimi: të mësojnë nxënësit historinë e gjuhës shqipe, origjinën dhe zhvillimin e saj gjatë shekujve.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin *Origjina e gjuhës shqipe*;
- bën pyetjen rreth përmbajtjes së tekstit;
- kërkon të lexojnë pjesën e shkëputur nga *Meshari* i Buzukut në dy variantet e tij;
- bën pyetjet: *Kur është shkruar teksti i parë? A e kuptoni? Në qoftë se jo, pse nuk e kuptoni? Çfarë ndryshimesh vini re ndërmjet këtyre dy teksteve në fushën e leksikut, fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës?*
- nxirret përfundimi se në tekstin e vitit 1555 vihet re që disa fjalë kanë dalë nga përdorimi: *hinje (ja), mangu (mashkull), fënjeshtra, (dritarja), grestënë (bulëzën), gjegj (dëgjoj),* se disa trajta fonetike e morfologjike janë të ndryshme nga të sotmet: *tue shkuo, mëndyrë, anshtë, tue pasune qyrë, em, thashunë, vote,* se struktura sintaksore është e ndryshme nga e sotmja, se në tekstin e vitit 1555 *mbizotërojnë periudhat me bashkërenditje,* se ndryshimet që vihen re në të dy tekstet e mësipërme tregojnë se gjuha shqipe ka ndryshuar gjatë kohëve;
- kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstet *Formula e pagëzimit dhe Meshari*;
- nxirret përfundimi se gjuha shqipe, ashtu si çdo gjuhë tjetër, ka ndryshuar gjatë shekujve, se dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, është *Formula e pagëzimit* e vitit 1462, se libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është *Meshari* i Gjon Buzukut i shkruar në vitin 1555;
- kërkon të lexojnë e të komentojnë tekstin *Dokumentet e para të gjuhës shqipe*;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-4 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 28

Historia e standardizimit të shqipes

Synimi: të mësojnë nxënësit veçoritë e përdorimit të presjes në fjalitë e përbëra me nënrenditje dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit* katër tekstet nga autorët shqiptarë;
- bën pyetjet: *A vini re ndryshime në gjuhën e këtyre teksteve? Cili prej tyre është më afër gjuhës që përdoret në librat e shkollës, në shtypin e përditshëm etj? Cili prej tyre është më larg? Pse ndryshon kaq shumë gjuha e këtyre teksteve? Kur janë shkruar tekstet e mësipërme?*
- nxirret përfundimi se tri tekstet e para janë shkruar para formimit të shqipes standarde, se ata janë shkruar në toskërishten letrare (*Të mukëtit*) dhe në gegërishten letrare (*Këndoisit, Legjenda e misrit*). Teksti i katërt (*Ti je i huaj*) është shkruar në shqipen standarde, prandaj ndryshon nga tekstet e mësipërme dhe është shumë afër me gjuhën e teksteve shkollore dhe të shtypit etj., se shqipja standarde është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar;
- kërkon të lexojnë tekstin *Historia e standardizimit të shqipes*;
- organizon diskutimin e tekstit;
- nxirret përfundimi se shqipja standarde është varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, se formimi i shqipes standarde, si varianti më i përpunuar i gjuhës shqipe, ka qenë një proces i gjatë, që ka filluar në shekujt XVI-XVIII dhe ka përfunduar më 1972;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-5 në *Fletoren e punës*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 29

Dialektet e gjuhës shqipe

Synimi: të njohin nxënësit dialektet e shqipes dhe veçoritë e tyre themelore.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë: *A ka ndryshime ndërmjet të folmes së vendbanimit të tyre dhe gjuhës standarde*, nëse ka, cilat janë ndryshimet dhe të thonë disa fjalë ose shprehje që janë karakteristike për vendbanimin e tyre;
- kërkon të lexojnë tekstet *Shka asht ma e ranë n'kët dyja? Fillimi im*;
- bën pyetjet: *Çfarë dallimesh vini re në gjuhën e përdorur në dy tekstet? Gjuha e cilit tekst ju duket më e afërt me gjuhën që përdoret në libra, në radio dhe në televizion? Cili nga dy tekstet është shkruar në shqipen standarde dhe cili në dialekt?*
- nxirret përfundimi se fragmenti i tekstit *Fillimi im* është shkruar në shqipen standarde. Fragmenti i tekstit *Shka asht ma e ranë n'kët dyja* është shkruar në dialekt;
- kërkon të lexojnë tekstin për dialektet dhe organizon diskutimin e tij;
- nxirret përfundimi se gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, *dialektin e Veriut* ose *gegërishten* dhe *dialektin e Jugut* ose *toskërishten*, se dallimet midis dy dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha, se folësit e tyre *kuptohen pa vështirësi* me njeri-tjetrin, se dallimet kryesore janë në sistemin *fonetik*, në strukturën *gramatikore* dhe në *leksik*;
- kërkon të bëjnë ushtrimet nr.1-4 në *Fletoren e nxënësit*.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Zgjidhjet e ushtrimeve të Fletores së punës

1. Përshkruajmë ambiente

1. A) 6, 4, 2, 3, 5, 1
B) foljet, mbiemrat, ndajfoljet
2. pjesë e përshkrimit të brendshëm
3. A) U zgjua nga ëndrra, erdhi në vete, fërkoj sytë me duart e veta dhe duart iu qullën, kishte qarë.
B) të vjetra, të plasaritura, të gjalla; popullore
C) mbiemrat
4. 3, 2, 1, 4
5. A) c) ndërtesë
B) c) 324 metër

2. Fjalitë e paplota

1. A) b) të paplota,
B) - Unë po shkoj në shkollë. Po ti ku po shkon?
- Ndoshta unë do të vijë nesër.
2. ata, ne, ju
3. a) e paplotë
b) e paplotë
c) e paplotë
4. a) Ndezi dritën.
b) Dhe pas meje ju.
c) Pas meje Bardhi.
ç) Asgjë tjetër.
d) Gjella me kripë, kripa me karar.
dh) Sipas kokës festën.
5. Në shtëpinë time.
Një kasolle më e ulët se një qilar.
... për tavan një çati degësh e barërash.
6. A) a) mbush, zbraz, nxjerr
b) shpie, çoj
c) thirri, bërtiti
B) a) Mbushe (zbraze, nxirre) me kova birë!
b) Çoje(shpie) në mulli!
c) Aeroplanë thirrën (bërtitën) !
C) a) veprorë. e dytë njëjës
b) veprorë. e dytë njëjës
c) veprorë. e tretë shumës

3. Stilet funksionale

1. a) stili letrar-artistik,
b) publicistik,
c) shkencor
ç) administrativ.

2. a) letrar-artistik
b) publicistik
c) shkencor
ç) administrativ
3. a) publicistik
b) shkencor
c) administrativ
ç) letrar-artistik

4. Stili letrar-artistik

1. kuptim i figurshëm i fjalëve, subjektiviteti, ndjeshmëria, ndjenja e së bukurës
2. A) c) artistik
B) Vujejtjet, ma tepër se koha, kishin lanë në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella, të shumta...
3. A) b) artistik,

5. Biseda telefonike

1. ...mënyra e prezentimit të bashkëbiseduesve, nga kultura e të folurit dhe nga fjalët që përdorim.
2. A) a) jozyrtare
B) a) temës së bisedës
b) kulturës së të folurit
c) emërtimit të institucioneve
ç) mënyrës se si i drejtohen njeri-tjetrit bashkëbiseduesit

6. Intervista

1. a) gazetari dhe këngëtari
b) gazetari
c) gjuhëtari
ç) Podgoricë
d) në gazetën “Koha javore” të Podgoricës
3. a) Flitet për veprimtarinë krijuese të shkrimtarit Fatos Kongoli.
b) Ky tekst nuk është intervistë, sepse intervista është e ndërtuar me pyetje dhe përgjigje.
c) Teksti i përket stilit publicistik
ç) Teksti është rrëfim për jetën e shkrimtarit.
d) Nuk ka pyetje e përgjigje, tregimtari është gazetari, teksti është kryesisht në vetën e tretë.
dh) Fjalët me kursive janë të shkrimtarit.

7. Stili shkencor

1. b) qartësia
ç) saktësia
d) fjalët me origjinë të huaj
dh) dhënia e fakteve
2. A) a) për poemën “Bagëti e bujqësia” të Naim Frashërit
b) për qytetin ilir Albanopolis
c) është një poezi kushtuar qytetit të Shkodrës
ç) për zogjtë grabitqarë

- B) PO PO JO PO
C. a) qartësia, saktësia;
b) qartësia, saktësia, fjalët me origjinë të huaj
c) qartësia, saktësia, fjalët me origjinë të huaj, dhënia e fakteve.

8. Reklama

1. c) rekomandim i mallit
d) vënie në dukje e cilësisë së mallit
dh) tërheqje e vëmendjes së lexuesit
2.
T-Mobile shpërblën. Bëhuni përdorues të Mobil Internetit dhe fitoni Netbook!
3.
Porositësi është T-Mobile.
4. a) me anë të shoqërimit të reklamës me fotografi
b) me anë të shtesës humoristike NA NA NA....
5. Lexo reklamën
- A. – Internet paketa KUDO QOFTË e prepaidit.
– Modemi PC MCI me çmim 29 €.
6.
A. Shitja e mallrave me zbritje çmimi në rastin e 14-vjetorit të themelimit të Qendrës Tregtare VOLI.
B) zbritje çmimi shpërblyese 10% me dt. 25.08.2005.

9. Ndërtimet me parafjalë

1. a) parafjalët
b) kallëzore, rrjedhore; emërore
2. A) në trotuar, me një kovë , me një furçë, në majën, prej dërrase, në shpirt, para tij, me një lartësi, prej dy metrash,
B) Në çfarë rase janë emrat në ndërtimet me parafjalë që gjetët.
trotuar (kall.), kovë (kall.), furçë (kall.), majën (kall.), dërrase (rrjedh.), shpirt (kall.), tij (rrjedh.), lartësi (kall.), metrash (rrjedh.)
4. b) Pa punë nuk jetohet.
d) Në Krajë për punë shkuam.
5. a) emërore
b) rrjedhore
c) rrjedhore
ç) emërore
d) kallëzore
dh) rrjedhore
e) kallëzore
6. shkakore;
vëndore;

kohore.

10. Lajmi

1. çfarë? ku? kur?
objektiv, subjektiv
2. Lajmi objektiv karakterizohet nga saktësia dhe vërtetësia e të dhënave; autori nuk paraqet mendimet dhe ndjenjat e tij lidhur me ngjarjen. Në lajmin subjektiv autori shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij për ngjarjen
3. A) b) joartistike
B) ç) lajme

11. Reportazhi

1. B) Teksti është reportazh.
2. A) 1) paraqitje e një objekti kulturor, 3) prania e vëzhgimeve, përshtypjeve, komenteve të gazetarit, 4) veçoritë, atmosfera; 5) vërtetësia (faktet, të dhënat); 6) kuriozitetet; rrëfimi i gjallë, veçoritë e stilit letrar-artistik.
B) 2) mungesa e aktualitetit (para disa ditësh, muajsh, vitesh);

12. Stili publicistik

1. vërtetësia, saktësia, thjeshtësia.
2. lajmi, reportazhi
3. Gazeta i drejtohet një numri shumë të madh njerëzish të cilët duhet t'i kuptojnë pa vështirësi ato që shkruhen në gazetë.
- 4.

Stili	Me ç'stil është shkruar teksti
letrar- artistik	/GABIM
shkencor	/GABIM
publicistik	SAKTË/

5.

Stili	Me ç'stil është shkruar teksti
letrar- artistik	/GABIM
shkencor	/GABIM
publicistik	SAKTË/

13. Lutja ose kërkesa zyrtare

1. 7, 5, 3, 4, 2, 6,1

2. c)
d)

3. ç)

4. b)

14. Stili administrativ

1. a),
c),
d)

2. d)

15. Emrat foljorë

1. lyerje, ngjitje, ardhje, fillim, mësim, pritje

2. -im -esë -atë
-im -esë -atë
-je -imë -më
-je -imë -më
-esë -imë -imë
-esë -atë

3. a) rregullimin,
b) fluturim,
c) regjistrimi,
ç) hapjen

4. a) kam menduar,
b) kam premtuar,
c) jemi njoftuar,
ç) janë përpjekur,
d) kanë analizuar,
dh) kanë biseduar

5. a) u çanë,
b) dyshoja ose kam dyshuar,
c) kanë ndikuar,
ç) është regjistruar

16. Plotësojmë formularë

1. C) Njëren e mban banka ose posta tjetren blerësi.

17. Gjuha letrare ose standarde

1. 1 - b;
2 - ç;
3 - c;
4 - d;
5 - a
2. 1. normës drejtshkrimore;
2. normës drejtshqiptimore;
3. normës morfologjike;
4. normës sintaksore;
5. normës leksikore
3. fshat, qumësht, skuq, gënjej, fshehurazi
4. norma drejtshkrimore
5. 1. përcakton rregullat e drejtshkrimit
2. përcakton format e fjalëve
3. përcakton përdorimin e fjalëve
6. A) Teksti i dytë
B) a) ndë, ay, munt, erth, u squa etj.
b) ndë, ay, iu munt, të flerë, duke endurë , ta zgjiithnjë, iu përgjeq etj.
c) pezhishka

18. Variantet gjuhësore joletrare ose jo standarde

2. PO

19. Ligjërimi bisedor

1. edhe me gjeste dhe me mimikë dhe jo vetëm me fjalë.
a) lëkundje të normës
c) ndikime dialektore e krahinore
d) përdoret më shpesh dialogu
dh) shoqërohet edhe me gjeste dhe me mimikë dhe jo vetëm me fjalë.
e) është kryesisht gojor
2. a) Më ka gënjyer. Më ka mashtruar.
b) Të njoh mirë.
c) Ata ishin të lumtur.
ç) Filmi ishte i mrekullueshëm.

20. Njoftimet publike

1. A) 2.
B) 1. njoftim privat, 2.3. njoftim publik.
2. A) Zyrtar.
Nga mënyra e të drejtuarit), nga mënyra e të shprehurit (Ju) dhe nga mënyra e përshëndetjes.

3. A) Teksti poshtë i shkruar majtas.
B) Sqaro llotarinë m-tel për të fituar biletën për në Kampionatin botëror të vaterpolos në Romë (Itali).
4. 1. Kompania celulare m-tel.
2. për llotarinë për bileta për Kampionatin botëror të vaterpolos në Romë (Itali).
3. Kampionati zhvillohet nga data 20 korrik deri me datën 1 gusht të vitit 2009.
4. Në Romë.
5. - Klientëve të kompanisë celulare m-tel.
- Për shërbimet dezhurnë dhe numrat e rëndësishëm telefonik të Podgoricës.
6. Nëpër rrugën “Ivan Cërnojeviq”.
3. njëqind vjetori i shpalljes Mbretëri të Malit të Zi.
4. A. 100 vjetori

21. Shkrimi i fjalëve me vizë në mes

1. a) shifër
b) shkronja

a),
ç),
e)
3. njëzetvjetori i shpalljes së Malit të Zi shtet ekologjik, njëqindpesëvjetori i nxjerrjes së kushtetutës së parë të Malit të Zi, njëqind vjetori i shpalljes Mbretëri të Malit të Zi, pesëqindnjëzetvjetori i themelimit të Shtypshkronjës së Cetinjës, shtatëdhjetëvjetori i Kryengritjes së 13 Korrikut
4. A) 100 vjetori njëqind-vjetorit, 100-vjetori
B) Kur përvjetori është shkruar me shkronja nuk vihet vizë.
Kur përvjetori shkruhet me shifra vihet vizë.

22. Tregimi

1. a)
ç)
d)
2. A) 1. 4. 2. 3. 5.
B) a) gabim
b) saktë
c) gabim
C) a) saktë
b) gabim
c) gabim
3. Veprat e M. Barletit u bënë burimi më i rëndësishëm ku patriotët shqiptarë mësonin historinë e epopesë legjendare të shekullit XV.

23. Fjalitë pavetore

1. c)
2. a)
b)
c)
3. a)
b)
c)
d)
dh)
4. a) flihet
b) bënte
c) vinte
ç) të flas
d) të jetojë
dh) të errësohet
5. a)
b)
ç)
d)

24. Fjalorët dhe përdorimi i tyre

1. dy gjuhësh, shumëgjuhësh
drejtshkrimorë, të antonimeve, enciklopedikë
2. a)
3. a) biografinë e tij
c) analizën e veprimtarisë së tij
ç) kontributin e tij shkencor
4. ç)

25. Korrektimi letrar i tekstit

1. Të bashkohet; të ndahet; të zëvendësohet, të ndërrohet ose plotësohet shkronja; ndërrim vendi; rënditja e duhur; në vazhdim; kryeradha.
2. Përmes Malësisë së Madhe rrjedh një lum i vogël me ujë të kthjellët e të ftohtë si akull; Cemi.

CEMI

Përmes Malësisë së Madhe rrjedh një lum i vogël me ujë të kthjellët e të ftohtë si akull; Cemi.

Cemi është një lum i rrëmbyeshëm malor, ose një përrua i madh në verë. Duke rënë në fushë midis Tuzit e Podgoricës, ai merr drejtimin nga perëndimi, ku bashkohet me Moraçën.

Në rrjedhën e sipërme të Cemit gjendet Kelmendi, më poshtë në të djathtë Triepshi, në të majtë Hoti dhe Gruda. Duke rënë në fushë, lumi le në të djathtë Dinoshën.

3. a) Vajza i tha shkrimtarit : “Mua më pëlqejnë shumë librat e tuaj.”
b) Ajo tha : “Kadareja është shkrimtari im i preferuar.”
c) Shkrimtari e pyeti vajzën : “Në ç’shkollë je.”
ç) Shokët më thanë: “Pa ardhur ti, ne nuk do të nisemi.”
4. 3, 5, 7, 10, 12, 14

26. Familja e gjuhëve

1. c) 6800
2. b) 225
3. gjermanike, sllave, greqishtja,
4. c) formon degë më vete në familjen indoevropiane.

27. Historia e gjuhës shqipe

1. ilirëve, ilirishtes
sllavere, sllaveshtes
3. A) b) 1462
B) Formula e pagëzimit
4. Meshari Buzuku

28. Historia e standardizimit të shqipes

1. c) 1879
2. b) 1908
3. b) 1972

4. A) /JO /JO/JO

5. 1 /JO
2 /PO

29. Dialektet e shqipes

1. dialektin e Veriut ... gegërishten ... toskërishten.

Shkumbinit

1. Shqipëri

2. Kosovë

4. Mal të Zi

2. Maqedoni

3. Greqi

2. b gegërishtja

3. kryet, shpina, fyti, kama, krahnori, gjuni, dhami, dhmalla, neni dorës

CIP – Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

37.016:811.18 (075.2) (076.1)

BECI, Bahri

Gjuha shqipe, sa e bukur, sa e mirë!: gjuha shqipe 9: për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare: libri i mësuesit/Bahri Beci; – Podgoricë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2009 (Podgorica: Studio Mouse). – 60 str.: ilustr.; 29 cm

Tiraž 50.

ISBN 978-86-303-1412-4

COBISS.CG-ID 14433808